



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 144

Tiranë – E premte, 25 tetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 124/2019, datë 17.10.2019	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 85/2017 “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar..... 11971
Vendim i Kuvendit nr. 125/2019, datë 17.10.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 11971
Vendim i Kuvendit nr. 126/2019, datë 17.10.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 11971
Vendim i Kuvendit nr. 127/2019, datë 17.10.2019	Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 14/2018 “Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për administratën publike’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, të ndryshuar..... 11972
Vendim i Kuvendit nr. 128/2019, datë 17.10.2019	Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 13/2018 “Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për të drejtat e njeriut’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, të ndryshuar..... 11972
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 10.10.2019	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj..... 11973
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 22, datë 4.10.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 25, datë 2.8.2013, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve” 11997
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 23, datë 14.10.2019	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015 “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit” 11998

Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 14.10.2019	Për një shtesë dhe ndryshim në udhëzimin nr. 2, datë 2.4.2019, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve”	11999
Udhëzim i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 16.10.2019	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 15.4.2016 “Procedurat e përlogaritjes së përfitimeve nga ligjet e mëparshme dhe të pagesave të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të ndryshuar”	12000
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 5749/5, datë 10.9.2019	Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës.....	12000
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 559, datë 10.10.2019	Për miratimin e rregullores, mbi vendosjen e kriterëve për planet kombëtare për përshpejtimin e çrrënjësjes së brucelozës, tuberkulozit dhe leukozës enzootike në gjedhë.....	12004
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 8946, datë 16.10.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës që lidh rrugët ‘Pjetër Budi’, ‘Qamil Guranjaku’ dhe ‘Stavri Vrinjao’”, Tiranë.....	12011

**VENDIM
Nr. 124/2019****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 85/2017 “PËR
ZGJEDHJEN E BYROSË DHE
PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partive të Djathta,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në pikën III të vendimit të Kuvendit nr. 85/2017 “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Sekretariati për Kërkimin Parlamentar, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare:

1. Kostaq Papa Anëtar

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 17.10.2019

**VENDIM
Nr. 125/2019****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 90/2017 “PËR
CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 17/1, pika 1, 21, pika 2, dhe 55, pikat 2 dhe 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partive të Djathta,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Zef Shtjefni (Grupi Parlamentar i Partive të Djathta) largohet nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe caktohet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme.

2. Deputeti Klajdi Qama (deputet jashtë grupeve parlamentare) caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 17.10.2019

**VENDIM
Nr. 126/2019****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 100/2017 “PËR
CAKTIMIN E ANËTARËVE
ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21/1, 55, pikat 2 dhe 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partive të Djathta,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:



1. Deputeti Zef Shtjefni caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

2. Deputeti Koçi Tahiri caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Politikën e Jashtme.

3. Deputeti Selami Jenishehri caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

4. Deputeti Ervis Meço caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Integrimin Europian dhe në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.10.2019

VENDIM
Nr. 127/2019

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 14/2018 “PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT ‘PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE’, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, 21/1, pika 1, e 55, pikat 2 dhe 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partive të Djathta,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 14/2018, “Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për administratën publike’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut bëhen këto shtesa:

Faqe | 11972

1. Në pikën III deputeti Adriatik Alimadhi caktohet anëtar.

2. Në pikën III/1 deputeti Kostaq Papa caktohet anëtar zëvendësues.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.10.2019.

VENDIM
Nr. 128/2019

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 13/2018 “PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT ‘PËR TË DREJTAT E NJERIUT’, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, 21/1, pika 1, e 55, pikat 2 dhe 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partive të Djathta,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 13/2018, “Për ngritjen e nënkomisionit ‘Për të drejtat e njeriut’, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën III deputeti Adriatik Alimadhi caktohet anëtar.

2. Në pikën III/1 deputeti Kostaq Papa caktohet anëtar zëvendësues.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.10.2019.

**VENDIM****Nr. 659, datë 10.10.2019**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
KOMBËTARE PËR PUNËSIM DHE
AFTËSI 2019–2022 DHE TË PLANIT TË
VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Vendimi nr.818, datë 26.11.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014–2020 dhe të Planit të veprimit për zbatimin e saj”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**STRATEGJIA KOMBËTARE
PËR PUNËSIM DHE AFTËSI**

2019–2022

**AFTËSI MË TË LARTA DHE PUNË MË
TË MIRË PËR TË GJITHË FEMRAT
DHE MESHKUJT**

2019

Hyrje

Vizioni i Strategjisë për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 është vlerësuar të jetë i njëjtë dhe vazhdim i strategjisë që është zbatuar në periudhën 2014–2018, duke ruajtur të njëjtin vizion dhe të njëjtat prioritetë strategjike.

Duke iu referuar treguesve të monitorimit të strategjisë së punësimit dhe aftësive të zbatuar në vitet 2014–2018 mund të vërehet se pothuajse të gjithë treguesit kanë përparuar pozitivisht, në krahasim me vitin bazë. Megjithatë, për disa tregues, progresi nuk ka qenë i mjaftueshëm për të arritur objektivat e vitit 2020. Plani i ri i veprimit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 ka rishikuar dhe adreson të gjithë objektivat dhe reformat e nisura me qëllim finalizimin e tyre, si dhe rishikimin e politikave të përcaktuara gjatë 4 viteve të zbatimit.

Nga raporti i vlerësimit afatmesëm u vlerësua se të 4 prioritetet strategjike të strategjisë, të zbatuara në vitet 2014–2018, janë ende relevante dhe nuk do të ndryshojnë në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022.

Situata e tregut të punës

Të dhënat e tregut të punës sugjerojnë se rritja ekonomike në Shqipëri, gjatë katër viteve të fundit, është përkthyer në përmirësime të konsiderueshme në tregun e punës. Krijimi i vendeve të punës u rikuperua nga një rënie e ndjeshme në vitin 2013 dhe rritja ekonomike e punësimit filluan të ecin paralelisht. Ndonëse shkalla e punësimit për personat e moshës 15–64 vjeç në Shqipëri u rrit nga rreth 50 për qind, në fund të vitit 2013, në 59.5 për qind në vitin 2018, duke shënuar kështu një nga raportet më të larta ndër vendet e Ballkanin Perëndimor, ajo mbetet nën mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian. Shkalla e punësimit është përmirësuar ndjeshëm, veçanërisht te gratë (nga 40 për qind në 2013 në 52.4 për qind në 2018-n). Sidoqoftë, pabarazia gjinore mbetet problematike, ku shkalla e punësimit e meshkujve është rreth 14 për qind më e lartë se ajo e femrave, potencialisht një reflektim i normave kulturore në lidhje me strukturën familjare dhe alternativat e limituara për kujdesin për fëmijët dhe të moshuarit.

Rritja në punësim, paralelisht, është shoqëruar me një rritje të pjesëmarrjes në forcat e punës, e cila arriti 68.3 për qind në 2018-n. Pjesëmarrja e grave u rrit me gati 10 për qind gjatë katër viteve, nga 50 për qind në 2013-n në 59.7 për qind në 2018-n. Sidoqoftë, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, gjithashtu, mbetet nën mesataret evropiane, me një diferencë të konsiderueshme midis meshkujve dhe femrave prej 17 për qind.



Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve (15–29) është më e ulët se sa për pjesën tjetër të popullsisë (50.1 për qind, me hendekun gjinor mbi 16 për qind). Shkalla e papunësisë së të rinjve më 2018-n ka rënë në 23.1 për qind, niveli më i ulët që nga viti 2012. Papunësia e regjistruar ka përjetuar gjithashtu një rënie shumë të konsiderueshme, nga 149,148 në 2015-n në 74,686 më 2018-n.

Përtej përmirësimeve të ndjeshme, Shqipëria ende përballet me sfida të rëndësishme për sa i përket garantimit të punësimit të sigurt dhe produktiv për të gjithë në moshë pune, nxitjen e krijimit të vendeve të punës me produktivitet më të lartë dhe sigurimin e integritetit në tregun e punës të grupeve vulnerabël, sidomos të varfërve, grave, të rinjve dhe grupeve të tjera të dizavantazuara. Një sfidë kryesore për Shqipërinë është përmirësimi i cilësisë së mundësive të punësimit.

Performanca e tregut të punës pasqyron pjesërisht strukturën e ekonomisë shqiptare – ku bujqësia vazhdon të dominojë më 37.4 për qind të totalit të punësimit, ndërsa prodhimi dhe shërbimet mbeten ende nën potencial. Sektori i bujqësisë në Shqipëri shërben për të absorbuar forcat e punës, veçanërisht në punë me produktivitet dhe paga të ulëta. Është pikërisht ky element që shpjegon shkallën relativisht të lartë të punësimit në Shqipëri (sidomos në punë me nivel të ulët aftësish), të shoqëruar me paga të ulëta, si dhe prevalencën e marrëveshjeve të punës joformale, me kohë të pjesshme dhe të vetëpunësimit. Zhvillimi i aktivitetit ekonomik me produktivitet më të lartë përgjatë zinxhirit të vlerës (qoftë kjo në sektorin e agropërpunimit, apo edhe më gjerë, në sektorin e prodhimit dhe atë të shërbimeve) do të krijonte mundësi për të siguruar punësim më cilësor.

Dinamikat e fundit të tregut të punës lidhen ngushtë me rimëkëmbjen e vazhdueshme ekonomike – megjithatë rritja e nënsektorëve me vlerë të shtuar të lartë dhe më të mirëpaguar është ende e kufizuar. Rritja e punësimit është nxitur kryesisht nga rritja e sektorëve si tekstilet, turizmi dhe tregtia, shërbimet shëndetësore dhe administrative. Në këtë kontekst, hartimi dhe zbatimi i reformave strukturore do të luajë një rol kyç në ruajtjen e tendencave aktuale pozitive të tregut të punës në Shqipëri, veçanërisht për të

mbështetur lëvizjen graduale të ekonomisë shqiptare drejt nënsektorëve me vlerë të shtuar dhe paga më të larta.

Ndërsa papunësia ka rënë ndjeshëm, duke arritur 12.3 për qind në 2018-n (dhe rënë më tej në 11.5 për qind në gjashtëmujorin e parë të 2019-s), ajo mbetet e lartë, sidomos e krahësuar me vendet e BE-së. Vetëm më pak se gjysma e të papunëve kërkojnë punësim nëpërmjet shërbimeve publike të punësimit, duke dëshmuar që skema e ndihmës ekonomike, zyrat e punës dhe politikat aktive të tregut të punës kanë nevojë të strukturohen më mirë për të mundësuar punësimin e të papunëve.

Duke u bazuar edhe në eksperiencën e vendeve të rajonit, Shqipëria ka mundësinë për ta orientuar ekonominë drejt sektorëve me vlerë të shtuar më të lartë dhe për të rritur produktivitetin brenda secilit sektor. Në vendet fqinje ka pasur një reduktim të ndjeshëm të punësimit në bujqësi, veçanërisht në sajë zhvendosjes së një pjese të popullsisë rurale në qytete. Kjo ka luajtur një rol kyç në rritjen e produktivitetit, duke mundësuar edhe krijimin e fermave të mëdha, të cilat realizojnë ekonomitë e shkallës. Ndërsa urbanizimi në Shqipëri do të vazhdojë, krijimi i një kornize efektive për titujt e pronësisë së tokës është i domosdoshëm për të mundësuar një treg aktiv të tokës në zonat rurale. Potenciali për të rritur vlerën e shtuar brenda sektorit për punonjës është substancial.

Shqipëria ka shënuar një përparim të konsiderueshëm, me 22% të të rriturve të moshës 30–34 vjeç që kanë kryer një arsim terciar (d.m.th. të tipit universitar) më 2015, një rritje prej mbi 10pp që nga viti 2010. Sidoqoftë, për shkak të strukturave specifike ekonomike dhe të punësimit në vend dhe kërkesë e ulët për punë, shumë të diplomuar të arsimit të lartë nuk mund të gjejnë punë që përputhen me kualifikimet e tyre. Kjo rezulton në nivele relativisht më të larta të papunësisë midis të diplomuarve të arsimit të lartë, veçanërisht femrave. Kjo sugjeron pabarazitë serioze të aftësive (d.m.th., nënshfrytëzimi). Disa njerëz me aftësi më të mira përpiqen të gjejnë punë jashtë vendit.

Falë përpjekjeve të vazhdueshme nga ministria përgjegjëse për AFP, regjistrimet në programet e AFP-së në poste sekondare u rritën



nga 17% më 2014 në 20.6% më 2018. Numri i studentëve të AFP-së është i vogël në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. AFP ka qenë opsioni më pak tërheqës në nivelin e mesëm të lartë, krahasuar me arsimin akademik, por ky imazh ka ndryshuar në vitet e fundit. Reformat janë në vazhdim, por përpjekje të mëtejshme në të gjithë sistemin janë të nevojshme për të plotësuar përmirësimet në institucionet pilot, të mbështetura nga donatorët. Shikoni më shumë detaje në seksionin B, më poshtë.

Numri i të rinjve të moshës 15–24 vjeç, të cilët nuk janë as në punësim, arsim dhe trajnim (në ET) mbetet i lartë (28.6% më 2018, krahasuar me mesataren e BE-së prej 10.6%). Kjo konfirmon ekzistencën e disbalancave të aftësive dhe probleme serioze me të diplomuarit e rinj, që të gjejnë punë.

Midis 2010-s dhe 2015-s, sidomos kohët e fundit, Shqipëria është përmirësuar ndjeshëm në shumicën e treguesve të BE-së 2020, siç është ulja e shkallës së të larguarve të hershëm nga arsimi dhe formimi i moshës 18–24 vjeç (10 pikë më pak), duke rritur ndjekjen e arsimit të lartë të personave 30–34 vjeç (mbi 10 pp më shumë) dhe ulja e nivelit të ulët të leximit, matematikës dhe shkencës. Përkundër tendencave pozitive, këta tregues janë akoma larg nga mesatarja e BE-së dhe objektivat e BE-së 2020.

Vizioni, qëllimi politik dhe përparësitë strategjike

Vizioni i Strategjisë për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 është i frymëzuar nga objektivi i përgjithshëm i ‘Evropa 2020’ për realizimin e një rritjeje të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi është që brenda vitit 2022 të kemi një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që mbështetet tek:

“Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për gjithë, femrat dhe meshkujt”

Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi për gjithë, femrat dhe meshkujt shqiptarë, gjatë gjithë ciklit të jetës. Ky qëllim do të arrihet me veprimtari politike koherente dhe të bashkërenduara, të cilat. Njëkohësisht, i përgjigjen kërkesës dhe ofertës për punë, si dhe sjellin mënjanimin e hendeqeve të përfshirjes

sociale. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi përqendrohet në katër përparësitë e mëposhtme strategjike:

A. NXITJA E MUNDËSIVE PËR PUNË TË DENJË, NËPËRMJET POLITIKAVE TË FRYTSHME TË TREGUT TË PUNËS

B. OFRIMI I ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL CILËSOR PËR TË RINJTË DHE TË RRRITURIT

C. NXITJA E PËRFSHIRJES SOCIALE DHE KOHEZIONIT TERRITORIAL

D. FUQIZIMI I QEVERISJES SË TREGUT TË PUNËS DHE I SISTEMEVE TË KUALIFIKIMEVE

Qëllimi i strategjisë

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 dhe planit të saj të veprimit ka për qëllim integrimin e politikave ekonomike, arsimore, formuese, si dhe sipërmarrëse, duke prodhuar një plan veprimi, i cili ka për qëllim rritjen e nivelit të punësimit, duke bërë të mundur një kalim gradual prej politikave pasive të papunësisë në ato aktive stimuluese të punësimit, si dhe duke i vënë theksin e duhur zhvillimit të forcës së punës në vend.

Programi i qeverisë 2017–2021 e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Evropian, Strategjinë Evropiane të Punësimit 2020, si dhe kërkesave për integrimin evropian të Shqipërisë në EU. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 është mbështetur në zbatim të orientimeve të programit të qeverisë, SKZHI-së dhe raportit të vlerësimit afatmesëm të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi të zbatuar në periudhën 2014–2018.

Objektivi i strategjisë

Objektivi kryesor i Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 dhe i saj i veprimit është identifikimi dhe skicimi i politikave të duhura nxitëse të punësimit në vend dhe formimit profesional të forcës së punës, me qëllim që të hapen vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës.

Plani i veprimit ka në qendër të tij rritjen e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, ofrimit dhe formimit profesional cilësor për të



rinjtë dhe të rriturit, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin e tregut të punës dhe të sistemit të kualifikimeve. Në përputhje me vizionin qeverisës, kjo strategji i shikon formimin profesional dhe punësimin të lidhura me njëra-tjetrën, duke synuar që shërbimet e arsimit dhe formimit profesional të jenë ngushtësisht të lidhura me ato të punësimit.

Masat e strategjisë

Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 dhe plani i veprimit do të përqendrohet në katër Objektiva Strategjike:

PRIORITETI A. NXITJA E MUNDËSIVE PËR PUNË TË DENJË NËPËRMJET POLITIKAVE TË FRYTSHME NË TREGUN E PUNËS

Formulimi dhe zbatimi i një politike aktive për punësimin përbën një element themelor për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të punësimit. Politikë që synojnë përmirësimin e perspektivave për punësim duhet të kenë një fushë më të madhe veprimi, ndërsa programet duhet të synojnë ata persona, të cilët janë në gjendje më të pafavorshme në tregun e punës, veçanërisht individët me nivel të ulët në arsim dhe kualifikim, femrat, të rinjtë, grupet e tjera të cenueshme dhe ata persona, të cilët jetojnë në zonat e pambuluara me shërbime punësimi. Prandaj, do të bëhet dizajni i kuadri të ri për nxitjen e punësimit, i cili do të sigurojë përdorimin e politikave më efikase dhe me më shumë burime për tregun e punës bazuar në ligjin nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”.

Modernizimi i shërbimit publik të punësimit

Një kuadër i tillë përqendrohet te:

- riorganizimi funksional i zyrave të punës sipas Modelit Kombëtar të Shërbimeve të Punësimit; Kjo nënkupton se:

- të gjitha zyrat e punës do të riorganizohen, sipas Modelit Kombëtar të Shërbimeve (një model, të njëjtat standarde dhe instrumente);

- stafi i zyrave të punës do të trajnohet për zbatimin e manualit të shërbimeve, përfshirë këshilluesit në shërbimet publike të punësimit, sipas planit individual të thelluar të punësimit, si dhe për zbatimin e planit të punësueshmërisë për grupet e veçanta;

- hartimi i një plani periodik të punësueshmërisë, sipas tri niveleve;

- sigurimi i cilësisë së shërbimeve nga secila zyrë do të verifikohet;

- publiku, bizneset dhe organizatat private dhe publike do të informohen mbi organizimin e shërbimit në tri nivele dhe për manualin e shërbimeve dhe planin e punësueshmërisë.

- *Modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë në AKPA*, e cila do të realizohet e fokusuar në:

- mjediset e zyrave të punës të organizuara dhe të pajisura sipas standardeve të Modelit Kombëtar të Shërbimeve të Punësimit;

- sistemi i ri i TIK-ut do të jetë i pilotuar dhe i shtrirë në të gjitha zyrat e punësimit, i aksesueshëm nga të gjitha institucionet e MFE-së dhe institucionet e tjera të interesuara, i përshtatshëm për të bërë të mundur kategorizimin e punëkërkuarve të riprofilizuar sipas modulit të raportimit statistikor funksional, si dhe proceset e aplikimit *on-line*;

- sistemi i TIK-ut i planifikuar të jetë i përdorur nga i gjithë stafi i trajnuar i zyrave të punës AKPA në të gjitha nivelet;

- procedurat e matjes së performancës do të jenë të pasqyruara në sistemin e ri informatik të shërbimeve të punësimit;

- do të jetë funksional moduli i raporteve të menaxhimit në nivel specialisti dhe në nivel zyre;

- do të krijohet harta digjitale, e cila do të jetë funksionale në nivel rajonal dhe lokal, për vendet e lira të punës, që mbulon gjithë Shqipërinë dhe e përditësuar vazhdimisht nëpërmjet in put-eve nga punëdhënësit, AKPA dhe punëkërkuarët;

- krijimi i një call center-i sipas një manuali metodologjik të miratuar;

- *web site-i* i AKPA-s do të jetë i kompletuar dhe i përditësuar me të gjithë informacionin për shërbimet në të treja nivelet dhe lehtësisht i aksesueshëm e i përdorshëm nga të interesuarit.

- *Zbatimi i sistemit të matjes së performancës për ofrimin e programeve aktive të tregut të punës*, i cili do të arrihet, si më poshtë:

- sistemi i matjes së performancës dhe monitorimit do të jetë krijuar, ngritur dhe zbatuar në të gjitha nivelet;

- dokumenti i vlerësimit për kapacitetin e burimeve njerëzore do të jetë hartuar;



- do të miratohet plani afatmesëm për zhvillimin e burimeve njerëzore për zbatimin e sistemit të performancës;

- trajnimi i stafit, sipas planit të zhvillimit;

- burimet njerëzore në AKPA dhe zyrat rajonale dhe vendore të punësimit do të jenë të vlerësuara me tregues performance në të gjitha nivelet.

Zgjerimi i gamës dhe shtrirjes së shërbimeve dhe programeve aktive të tregut të punës (PATP)

Programet aktive të tregut të punës do të riprojektohen me qëllim ofrimin e një pakete gjithëpërfshirëse shërbimesh dhe programesh, për të lehtësuar kalimin e individëve drejt punës së denjë dhe për të përfshirë një strategji aktivizimi. Riprojektimi do të fillojë me:

- *Hartimin dhe diversifikimin e PATP-ve në bazë të nevojave të grupeve me rrezik të lartë për t'u bërë të papunë afatgjatë*, i cili do të realizohet nëpërmjet:

- vlerësimit të nevojave të grupeve të veçanta për mbështetje me PATP të identifikuar;

- kuadri ligjor dhe rregullator për zbatimin e PATP-ve do të jetë i rishikuar në bazë të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", për të mbështetur ofrimin e PATP-ve të përmirësuara, të diversifikuara dhe të përshtatura për rajone të veçanta, mbi baza gjinore dhe grupesh sociale;

- programi i vetëpunësimit do të jetë i hartuar dhe i zbatuar;

- kryerja e studimit të fizibilitetit për hartimin, zbatimin dhe analizën e kosto-përfitimit të një programi aktiv të tregut të punës që synon të rinjtë që nuk janë në punësim, arsim apo trajnim (nëET).

- plani kombëtar i veprimit për zbatimin e garancisë rinore (me fokus të rinjtë NEET = jo në trajnim dhe jo në punësim) do të jetë i hartuar dhe do të zbatohet skema e garancisë rinore për përfitues të kategorisë të NEET

- politikat aktive të tregut të punës të jenë të përmirësuara, bazuar në rezultatet e monitorimit.

- *Përmirësimi i procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve të nxitjes, me qëllim përmirësimin e eficientës dhe të impaktit të tyre*; i cili do të realizohet nëpërmjet:

- metodologjia (procedurat) e prioritizimit të fondeve të jenë sipas fushave të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit të hartuara dhe të aprovuara nga MFE-ja;

- fondet të jenë të shpërndara sipas prioriteteve dhe planit të punësueshmërisë;

- programet e nxitjes do të jenë të zbatuara në të gjithë vendin, në mënyrë eficiente dhe efektive, si edhe duke siguruar barazi gjinore, përfshirë kontraktimin;

- kriteret dhe peshat e vlerësimit të aplikimeve të rishikuara periodikisht.

Garantimi i punës së denjë nëpërmjet forcimit të rolit dhe funksionimit të inspektimit në punë.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore do të shtojë përpjekjet për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të punës dhe për rritjen e shëndetit e sigurisë në punë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zgjerimit të fushës së veprimit dhe mbulimit nga inspektimi i punës, pra sistemit të paralajmërimeve dhe gjobave, në mënyrë që të përfshijë më mirë ekonominë informale, si edhe ngritjes së mekanizmave për shkëmbimin e informacionit me agjenci të tjera zbatuese. Janë parashikuar disa masa për realizimin e objektivave të mësipërm që janë:

- *Forcimi i sistemit të inspektimit dhe garantimi i mbulimit të të gjithë territorit me këtë sistem*, i cili do të realizohet nëpërmjet:

- sistemi modern dhe profesional i inspektimit do të jetë i ngritur në të gjithë vendin, duke siguruar zbatimin e legjislacionit të punës dhe sigurisë e shëndetit në punë;

- kuadri nënligjor për sigurinë/shëndetin në punë do të jetë i miratuar;

- do të miratohet Udhëzuesi praktik për inspektimin bazuar në praktikën e Kodit Evropian për inspektimin;

- Programi për Integritetin dhe Parandalimin e Korrupsionit në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore do të jetë i miratuar dhe i zbatuar;

- do të hartohet dhe miratohet plani i veprimit për trajnimet në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;

- do të ngrihen mekanizmat për shkëmbimin e informacionit me agjencitë e tjera zbatuese (AKPA, zyrat e tatimeve), me qëllim përmirësimin e mbulimit të njësive ekonomike dhe të punëtorëve;

- kuadri ekzistues ligjor dhe rregullues për inspektimin e punës do të jetë i përputhur me



direktivën e BE-së mbi sanksionet ndaj punëdhënësve, të cilët punësojnë emigrantë me dokumente jo të rregullta;

- roli i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore do të fuqizohet për të zbatuar detyrimet nga ligji i nxitjes së punësimit dhe Kodi i Punës.

- *Inspektimi dhe monitorimi i veprimtarisë së agjencive private të punësimit të përkohshëm*; i cili do të sigurohet nëpërmjet:

- partneriteteve vendore, që përfshijnë agjencitë private të punësimit së bashku me partnerët e tjerë;

- agjencitë private të punësimit do të raportojnë tek autoritetet përkatëse përgjegjëse rregullisht dhe në mënyrë transparente mbi shërbimet e ofruara për popullsinë (femra dhe meshkuj) në Shqipëri dhe jashtë vendit;

- do të sigurohen statistikave të rregullta dhe të disponueshme mbi numrin e qytetarëve shqiptarë (femra dhe meshkuj) të mbështetur me punësim.

Zhvillimi dhe zbatimi i modelit për monitorimin e programeve aktive të tregut të punës (PATP) me ndjeshmëri për çështjet gjinore, i cili do të realizohet sipas masave të mëposhtme:

- *Përcaktimi dhe miratimi i modelit për monitorimin e PATP-ve*, ku:

- kuadri metodologjik i vlerësimit dhe monitorimit të jetë i hartuar për PATP-të;

- instrumentet të jenë të përmirësuara për monitorimin e përfshirjes së grupeve të veçanta në PATP.

- *Zbatimi i planit të monitorimit të PATP-ve*, ku:

- struktura e monitorimit të programeve aktive të tregut të punës të jetë e ngritur;

- programet aktive të tregut të punës do të jenë të monitoruara periodikisht në bazë të indikatorëve të standardizuar.

- *Përgatitja e raporteve të monitorimit të PATP-ve* nëpërmjet hartimit të këtyre raporteve në mënyrë periodike.

PRIORITETI B. OFRIMI I ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL CILËSOR PËR TË RINJTË DHE TË RRRITURIT.

Investimet për kapitalin njerëzor dhe cilësinë e sistemit të arsimit e formimit janë në qendër të një ekonomie inovative dhe konkurruese, duke ofruar më shumë vende pune sa më cilësore. Mundësitë e qasjes tek arsimi dhe formimi i një

cilësie të lartë përbëjnë një nga elementët kryesorë për përcaktimin e punësueshmërisë së forcës së punës dhe për të ndikuar mbi klimën e investimeve. Rritja e punësueshmërisë së meshkujve dhe femrave nënkupton sigurimin se ata po marrin aftësitë, njohuritë dhe qëndrimet e duhura, të cilat do t'u mundësojnë gjetjen e punës dhe përballjen me ndryshimet e paparashikuara në tregun e punës gjatë gjithë përvojës së punës.

Përpjekjet për të rritur shkallën e pjesëmarrjes në arsimin dhe kualifikimin profesional për të kapërcyer hendekun që ekziston krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian do të vazhdojnë, ndërkohë që rritja e cilësisë së rezultateve, përgatitja e kualifikimeve për sektorët ekonomikë me përparësi, përmirësimi i imazhit të cilësisë dhe i rëndësisë së sistemit të arsimit dhe formimit profesional e parashikimi i nevojave për aftësi do të jenë në qendër të reformave të kësaj strategjie. Duhet bërë edhe përcaktimi i hendeqeve arsimore dhe trajtimi i tyre në rajone të ndryshme dhe në grupe të ndryshme të popullsisë.

Të nxënit gjatë gjithë jetës dhe kualifikimi janë të dobishëm për nxitjen e konkurrencës së ndërmarrjeve dhe për rritjen e produktivitetit të punës, si edhe për përmirësimin e cilësisë së punës. Prandaj, qasja të mundësitë e të nxënit cilësor gjatë gjithë jetës do të zgjerohet me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së individëve të gjitha moshave, duke përfshirë edhe ata me nevojat të veçanta dhe grupet në nevojë e në dizavantazh. Masat e parashikuara janë si më poshtë:

Optimizimi i ofruesve të AFP-së në nivel individual dhe rrjeti për të siguruar një ofertë cilësore dhe më të larmishme, e cila do të arrihet nëpërmjet:

- *Diversifikimit të ofertës në AFP, në përputhje me nevojat e tregut të punës;*

- oferta e AFP-së do të jetë e diversifikuar në përputhje me nevojat e tregut, trendet e migracionit dhe ato demografike, si dhe në bazë të parimeve të shumëfunktionalitetit, barazisë, diversitetit dhe fleksibilitetit;

- do të sigurohet ofertë e përditësuar, sipas nevojave të tregut të punës;

- do të hartohet raport për kapacitetet e ofruesve të AFP-së për të ofruar kualifikime profesionale pas të mesme;



- kualifikime profesionale pas të mesme do të jenë përzgjedhur nga ofruesit;

- kuadri ligjor për Njohjen e Njohurive të Mëparshme (NJNM) do të jetë i konsoliduar;

- institucionet zbatuese të NJNM-së do kenë ndarje të qartë rolesh për zbatimin e NJNM;

- sektorët prioritarë për zbatimin e NJNM-së janë identifikuar dhe, gjithashtu, NJNM në dy profesione është pilotuar.

- *Riorganizimi i rrjetit të ofruesve, duke marrë në konsideratë përputhjen e ofertës me kërkesën rajonale, nëpërmjet masave të mëposhtme:*

- gjetjet e vlerësimit të performancës së ofruesve;

- do të hartohet harta e gjeografike për operacionalizimin e riorganizimit të rrjetit të ofruesve të AFP-së.

- infrastruktura e ofruesve do të jetë e përmirësuar në bazë të investimeve të kryera.

- strukturat organizative të ofruesve të AFP-së do të jenë të miratuara dhe në zbatim.

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të AFP-së, nëpërmjet:

- *Analizimit të situatës aktuale të sistemit/sistemeve të informacionit që veprojnë në fushën e AFP-së*, ku parashikohet hartimi i raportit të situatës aktuale të sistemit të menaxhimit të informacionit në AFP. Nga kjo analizë do të dalin rekomandime për krijimin e një sistemi të unifikuar të menaxhimit të informacionit në AFP.

- Përcaktimi i modelit/sistemit të menaxhimit të informacionit të AFP-së ku parashikohet të jetë një sistem i unifikuar i menaxhimit të këtij informacioni.

- Krijimi i një sistemi të unifikuar të menaxhimit të informacionit në fushën e AFP-së ku parashikohet një sistem i unifikuar i menaxhimit të informacionit të AFP-së i cili do të jetë i përditësuar dhe kapacitetet e stafëve në nivel qendror dhe në nivel ofruesi do të jenë të konsoliduara.

Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional bazuar në kornizën e sigurimit të cilësisë në sistemin e AFP-së

- *Përcaktimi dhe zbatimi i procesit akreditimit të ofruesve* që do të arrihet nëpërmjet masave në vijim:

- kapacitetet e stafëve të angazhuara në proces akreditimi të konsoliduara, publikë dhe privatë të AFP-së;

- modeli i akreditimit të ofruesve dhe programeve të AFP-së do të jetë i miratuar;

- do të konsolidohen kapacitetet e stafëve të angazhuara në proces akreditimi;

- ofruesit e AFP-së (publikë dhe privatë) janë akredituar ose në proces akreditimi.

- *Përmirësimi i procedurave të licencimit dhe monitorimit të ofruesve privatë të AFP-së* që do të arrihet nëpërmjet rishikimit dhe miratimit të procedurave të licencimit.

- *Fuqizimi i funksionit të inspektimit të ofruesve të AFP-së* e cila do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve në vijim:

- njësia përgjegjëse për inspektimin, si dhe standardet e procedurat e inspektimit do të jenë të përcaktuara;

- zbatimin e planit për inspektimin periodik të ofruesve të AFP-së.

- *Konsolidimi i procesit të vetëvlerësimit të ofruesve publikë të AFP-së*, nëpërmjet:

- hartimit të raporteve të vetëvlerësimit të ofruesve publikë të AFP-së;

- rekomandimet e procesit të vetëvlerësimit do të jenë të reflektuara në planet e zhvillimit të ofruesve.

- *Ngritja e sistemit të monitorimit të ofruesve publikë të AFP-së sipas aktiviteteve më poshtë:*

- njësia përgjegjëse dhe standardet e monitorimit të jenë të përcaktuara.

- planet e monitorimit periodik të ofruesve publikë të AFP-së do të jenë të hartuara dhe të zbatuara.

Forcimi i lidhjeve midis të nxënës dhe punës dhe lehtësimi i kalimit në punë, e cila do të zbatohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

- *Përmirësimi i modelit të praktikave profesionale në biznes në sistemin e ofruesve publikë të AFP-së* (me bazë shkollën);

- Modeli i praktikave profesionale në biznes do të jetë pjesë integrale e programeve (kurrikulave) të AFP-së;

- Paketa rregullatore për modelin e praktikave profesionale në biznes do të jetë e miratuar;

- Funksioni i koordinatorit për marrëdhënien me biznesin do të jetë i institucionalizuar në të gjithë ofruesit e AFP-së (si pjesë e njësisë së zhvillimit);

- Trajnimet të jenë të kryera për stafet e ofruesve të AFP-së dhe bizneseve për zbatimin e modelit të praktikave profesionale;



- Mekanizmi për vlerësimin për përmirësimin e modelit të praktikave profesional do të jetë i hartuar dhe i zbatuar.

- *Forcimi i bashkëpunimit shkollë-biznes për aspekte të ndryshme të zbatimit të ofertës (kurrikula, zhvillimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve, vlerësimi i nxënësve, etj.);*

- Do të organizohen fushata ndërgjegjësimi për përfshirjen e biznesit në aspekte të ndryshme të ofertës së AFP-së;

- Marrëveshjet e bashkëpunimit do të jenë të nënshkruara ndërmjet ofruesve të AFP-së dhe bizneseve;

- Rastet e suksesshme të angazhimit të biznesit në AFP do të promovohen.

- *Ngritja e sistemit të orientimit të karrierës për ofruesit e AFP-së;*

- Funksionet e këshillimit të karrierës brenda njësisë së zhvillimit të jenë të zbatuara;

- Kapacitetet e njësive të zhvillimit për këshillim dhe orientim karriere janë ngritur;

- Sistemi i informacionit për orientim karriere të jetë i ngritur;

- Informacioni i përditësuar për karrierën do të jetë i vënë në dispozicion të nxënësve dhe kursantëve të AFP-së.

- *Ngritja e modelit të arsimit të dyfishtë në fushën e zejtarisë;*

- Kuadri ligjor për ngritjen dhe funksionimin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë do të jetë i miratuar;

- Do të hartohen raporte për stadin e zhvillimit të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

- Udhërrëfyes për zbatimin e arsimit të dyfishtë të jetë i hartuar dhe i zbatuar.

Zhvillimi profesional fillestar dhe i vazhduar i drejtuesve, mësimdhënësve dhe stafëve mbështetëse të AFP-së, i cili do të arrihet nëpërmjet masave të mëposhtme:

- *Përcaktimi dhe zbatimi i modelit të kualifikimit fillestar të mësimdhënësve të AFP-së;*

- Modeli i kualifikimit fillestar të mësimdhënësve në AFP do të jetë i përcaktuar;

- Kuadri ligjor për zbatimin e modelit të kualifikimit fillestar të mësimdhënësve të AFP-së i miratuar;

- Modeli i kualifikimit fillestar të mësimdhënësve të AFP-së i zbatuar në bazë të modaliteteve dhe kuadrit ligjor të miratuara.

- *Përmirësimi i politikave të rekrutimit për mësimdhënësit e AFP-së;*

Procedurat e rekrutimit për mësimdhënësit në AFP të jenë të miratuara e dhe të zbatuara.

- *Kualifikimi i vazhduar i mësimdhënësve;*

- Nevojat për trajnim të mësimdhënësve të AFP-së në nivel kombëtar dhe në nivel ofrues të jenë të identifikuar në mënyrë periodike;

- Instrumentet e nevojshme për zbatimin e zhvillimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve të AFP janë zhvilluar dhe buxhetet janë mirëpërcaktuar;

- Kualifikimi fillestar dhe i vazhduar i stafit drejtues dhe mbështetës të ofruesve të AFP-së;

- Modeli i përcaktuar dhe paketat e trajnimit fillestar dhe të vazhduar për drejtuesit dhe stafet mbështetëse të ofruesve të AFP-së;

- Trajnimet e zhvilluara për drejtuesit dhe stafet mbështetëse të ofruesve të AFP-së;

- Rrjetet e drejtuesve të AFP-së, të cilat shkëmbejnë informacion/ përvoja për problematika të ndryshme, të siguruar.

Rritja e imazhit të AFP-së dhe informimi në lidhje me ofruesit, kualifikimet dhe ofertën e AFP-së.

- *Organizimi i fushatave publicitare, promovuese dhe ndërgjegjësuere mbi rëndësinë dhe mundësitë e ofrura nga AFP dhe TNGjGjJ për vajzat, djemtë, gratë dhe burrat në zonat urbane dhe rurale,* ku janë parashikuar:

- Evente promovuese më të fokusuar për të arritur te gratë dhe vajzat në zonat urbane dhe rurale;

- Këshillimi i vajzave dhe djemve që zgjedhin trajnimin në profesione jotradicionale dhe përfshirja e vajzave në kurse jotradicionale, veçanërisht në sektorë që kanë shumë potencial dhe produktivitet, të promovuar publikisht.

- *Përgatitja për pjesëmarrjen e nxënësve të AFP-së në konkurse kombëtare, evropiane dhe botërore të aftësive, promovimi në media;*

- Anëtarësimi i Shqipërisë në EuroSkills/World Skills.

- Pjesëmarrja e nxënësve/kursantëve të AFP-së në konkurset ndërkombëtare të organizuara nga EuroSkills dhe/ose World Skills, pas anëtarësimit.

PRIORITETI C. NXITJA E PËRFSHIRJES SOCIALE DHE KOHEZIONIT TERRITORIAL.



B6.2.2	Pjesëmarrja e nxënësve/kursantëve të AFP-së në konkurse ndërkombëtare të organizuara nga EuroSkills dhe/ose World Skills pas anëtarësimit.	9240	MFE/AKAAPK/Ofruesit e AFP-së		I 2021	IV 2022	540,000	-	-	540,000



Tabela 1

PLANI I VEPRIMIT
Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
(2019–2022)

I. QËLLIMI STRATEGJIK: Nxitja e vendeve të punës cilësore dhe mundësi për aftësi për të gjitha femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë gjithë ciklit të jetës me qëllim brenda vitit 2022 të transformohet në një treg pune gjithëpërfshirës

II. Qëllimi i politikës: Promovimi i përfshirjes sociale dhe i kohezionit territorial

III. PROGRAMI BUXHETOR 1 QË KONTRIBUON PËR QËLLIMIN E POLITIKËS: 10550/9240

Nr.		Referenca e Mases me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative (në ALL)	Burimi i mbulimit (në ALL)		Hendeku financiar (në ALL)
					Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Buxhet shteti	Financim i huaj	
C1.	OBJEKTIVI SPECIFIK: Zgjerimi i mbulimit, përfshirjes dhe efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe arsimimit dhe formimit profesional për të rinjtë dhe të rriturit përfshirë dhe popullsinë e rrezikuar për përjashtim.	KODI I PROGRAMI BUXHETOR	Drejtues	Pjesëmarrësit						
C1.1	Vlerësimi i nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zonat e pambuluara.	10550	MFE/AKPA	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); INSTAT;	IV 2020	IV 2022				
C1.1.1	Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime punësimi dhe të AFP-së në zonat e pambuluara të identifikuar me rekomandimet përkatëse.	10550	MFE/AKPA		IV 2020	II 2021	1,798,176	0	0	1798176
C1.1.2	Metodologjitë e rishikuara të anketave statistikore për të marrë në konsideratë edhe femrat dhe meshkujt që jetojnë në zonat e pambuluara.	10550	MFE/AKPA	INSTAT;	IV 2020	II 2021	555,600	0	0	555600
C1.1.3	Regjistrimi i punëkërkuësve të papunë, si femra ashtu dhe meshkuj, nga zonat e pambuluara.	10550	MFE/AKPA	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);	IV 2021	IV 2022	31,021,200	0	0	31021200
C1.2.	Hartimi i planit të shtrirjes territoriale të shërbimeve të punësimit dhe arsimit dhe formimit profesional.	10550	MFE/AKPA		II 2021	IV 2022				
C1.2.1	Plani i detajuar për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe të AFP-së në zonat e pambuluara.	10550	MFE/AKPA		II 2021	IV 2021	660,150	0	0	660150
C1.2.2	Percaktimi i shërbimeve të punësimit dhe pjesëmarrja e garantuar në programet e AFP-së për individët që jetojnë në zonat e pambuluara.	10550	MFE/AKPA		IV 2021	IV 2022	555,600	0	12131000	-11575400
C1.3	Zbatimi i planit të shërbimeve në zonat e pambuluara.	10550	MFE/AKPA		I 2021	IV 2022				
C1.3.1	Modalitetet dhe marrëveshje bashkëpunimi me njësitë vendore duke përcaktuar rolet reciproke dhe llojin e shërbimeve që do të ofrohen në zonat e pambuluara me zyra punësimi dhe formimi.	10550	MFE/AKPA		II 2021	IV 2022	277,800	0	0	277800
C1.3.2	Pika shërbimi pranë njësite të qeverisjes vendore.	10550	MFE/AKPA		II 2021	IV 2022	5,170,200	0	0	5170200
C1.3.3	Shërbimet e ofruara nga OJF-të e kontraktuara nga SHKP/AKPA.	10550	MFE/AKPA		I 2021	III 2022	0	0	0	0
C1.4	Zbatimi i planit për AFP në zonat e pambuluara.	10550/9240	MFE/AKAFPK	OJF të specializuara	IV 2019	IV 2022				
C1.4.1	Nevojat për kualifikime profesionale të identifikuar.	10550/9240	MFE/AKAFPK/AKPA	OJF të specializuara	IV 2019	IV 2019	239,364	100000	3639300	-3499936
C1.4.2	Ridizënjimi i paketave të aftësive dhe kualifikimeve të përshtatura për ekonominë rurale bazuar në vlerësimin e analizës së hendekut të aftësive. Mënyra dhe modalitetet e ofrimit të kualifikimeve profesionale të përcaktuara dhe të pilotuara.	9240	MFE/AKAFPK	OJF të specializuara	I 2021	IV 2021	6,393,640	6000000	7278600	-6884960
C1.4.3	Roadmap për agjendën e formimit të të rriturve në Shqipëri bazuar në agjendën europiane.	9240	MFE/AKAFPK	OJF të specializuara	IV 2019	I 2020	598,410	1000000	0	-401590
C1.4.4	Shërbimet e ofruara në zonat e pambuluara.	10550/9240	MFE/AKAFPK/AKPA	OJF të specializuara	IV 2019	IV 2022	97,245,600	75000000	0	19745600



C1.4.5	Kurset e formimit profesional të ofruara për punëkërkesit e papunë, si femra, ashtu edhe meshkuj në zonat e pambuluara.	10550/9240	MFE/AKAFPK/AKPA	OJF të specializuara	IV 2019	IV 2022	3,320,652	2000000	0	1320652
C1.5	Rritja e aksesit për shërbime të punësimit dhe të AFP-së për grupet e veçanta.	10550/9240	MFE/AKPA	OJF të specializuara	III 2019	IV 2022				
C1.5.1	Modalitetet dhe procedurat për kontraktimin e aktorëve të tjerë për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara.	10550/9240	MFE/AKPA	OJF të specializuara	III 2019	IV 2019	530,100	0	2185000	-1654900
C1.5.2	Kuadri ligjor i miratuar për kontraktimin e subjekteve të treta për zbatimin në cilësi dhe në kohë për programet e punësimit.	10550/9240	MFE/AKPA	OJF të specializuara	I 2020	IV 2020	294,500	0	1092500	-798000
C1.5.3	Buxheti i përcaktuar dhe i kontraktuar tek OJF-të e specializuara.	10550/9240	MFE/AKPA	OJF të specializuara	I 2020	IV 2021	185,200	0	133441000	-133255800
C1.5.4	Rishikimi dhe hartimi i masave të reja të nxitjes së punësimit (PNP) dhe masat aktive të tregut të punës (PATP), si dhe zgjerimi i gamës dhe fushëveprimit të programeve të ofruara dhe nxitjen e grupeve veçanta duke përfshirë modellet/procedurat të konsoliduara në nivel rajonal dhe në nivelin lokal.	10550/9240	MFE/AKPA	OJF të specializuara Shërbimi Social Shtetëror	I 2022	IV 2022	736,250	0	2731250	-1995000
C2.	OBJEKTIVI SPECIFIK: Nxitja e riintegritimit në tregun e punës.		Drejtues	Pjesëmarrësit						
C2.1	Hartimi i skemës riintegruese në tregun e punës të përfutuesve të skemës së Ndihmës Ekonomike.	1110/10550	MFE/AKPA	MSHMS Njësitë e qeverisjes vendore;	II 2020	IV 2022				
C2.1.1	Shërbimet e punësimit të harmonizuara me Shërbimin Social Shtetëror, të cilat adresojnë nevojat e individëve, që përballen me disavantazhe të shumta, për të maksimizuar ndërveprimin midis politikave pasive dhe aktive, për të identifikuar e minimizuar faktorët shkurajues për hyrjen në tregun e punës dhe për të realizuar daljen nga skema e ndihmës ekonomike. - Rishikimi i programit aktual të mirëqenies në punë me fokus në përmirësimin e tranzicionit nga përfitimet në para, përmirësimin e punësueshmërisë dhe punësimit, si dhe opsionet për zgjerimin e programit me një përqendrim më të madh në lidhjet me PPE / ALMM dhe riintegrimin në tregun e punës për gratë dhe burrat .	1110/10550	MFE/AKPA	MSHMS Njësitë e qeverisjes vendore; Shërbimi Social Shtetëror	II 2020	IV 2022	3,029,904	0	4916250	-1886346
C2.1.2	Mekanizmi monitorues i ngritur, i cili gjurmon situatën e femrave dhe meshkujve vulnerabël dhe/ose të përjashtuar nga shoqëria në Shqipëri, duke përfshirë ato që janë prekur nga emigracioni.	1110/10550	MFE/AKPA	MSHMS Njësitë e qeverisjes vendore; Shërbimi Social Shtetëror	II 2021	IV 2022	3,029,904	0	12131000	-9101096
C2.2	Nxitja e mobilitetit të brendshëm për punësim.	10550	MFE/AKPA		I 2020	IV 2022				
C2.2.1	Sistemi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet zyrave të punësimit për vendet e lira të punës për plotësimin e ofertave mes rajoneve të tjera.	10550	MFE/AKPA		I 2020	IV 2022	757,476	0	2426200	-1668724
C2.2.2	Ngritja e mekanizmave të bashkëpunimit dhe referimit të zyrave të punësimit për ndërmjetësimin e punëkërkuarve të papunë në rajone të tjera.	10550	MFE/AKPA		III 2020	IV 2022	757,476	0	3639300	-2881824



Tabela 1

PLANI I VEPRIMIT
Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
(2019–2022)

I. QËLLIMI STRATEGJIK: Nxitja e vendeve të punës cilësore dhe mundësi për aftësi për të gjitha femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë gjithë ciklit të jetës me qëllim brenda vitit 2022 të transformohet në një treg pune gjithëpërfshirës

II. Qëllimi i politikës: Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemit të kualifikimeve profesionale

III. PROGRAMI BUXHETOR 1 QË KONTRIBUON PËR QËLLIMIN E POLITIKËS: 10550/9240/1110

Nr.		Referenca e masës me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative (në ALL)	Burimi i mbulimit (në ALL)		Hendeku financiar (në ALL)
					Afati i fillimit	Afati mbarimit		Buxhet shteti	Financim i huaj	
D1.	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e performancës së qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.	KODI I PROGRAMI BUXHETOR	Drejtnes	Pjesëmarrësit						
D1.1	Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) si institucion përgjegjës për administrimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave të punësimit dhe menaxhimit të ofruesve publike të AFP-së.	10550	MFE/AKPA	DAP	II 2019	IV 2022				
D1.1.1	Aktet nënligjore përkatëse të hartuara dhe miratuara.	10550	MFE/AKPA		II 2019	I 2020	6,115,860	0	2,002,325	4,113,535
D1.1.2	Struktura dhe përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zhvillimin e politikave të punësimit dhe menaxhimit të AFP-së të miratuara.	10550	MFE/AKPA	DAP	III 2019	IV 2019	671,672	-	2,731,250	(2,059,578)
D1.1.3	Stafi i AKPA-s i rekrutuar/ i rikonfirmuar.	10550	MFE/AKPA	DAP	III 2019	II 2020	920,150	-	-	920,150
D1.1.4	Buxheti i alokuar sipas funksioneve të institucionit përgjegjës për zbatimin e politikave të punësimit dhe menaxhimit të ofruesve të AFP-së.	10550	MFE/AKPA		I 2020	IV 2022	1,798,920	-	-	1,798,920
D1.1.5	Staf i trajnuar sipas funksioneve dhe përgjegjëse të AKPA, si dhe për aplikimin dhe menaxhimit të projekteve të financuara nga programet e BE-së (EaSI, Erasmus+ etj.)	10550	MFE/AKPA		I 2020	IV 2021	6,836,120	-	19,118,750	(6,820,130)
D1.1.6	Struktura/strukturat e ngritura për administrimin, zhvillimin dhe perspektivën e AFP-së në Shqipëri dhe tabela organizative dhe detyrat e përcaktuara.	10550	MFE/AKPA		IV 2019	IV 2020	-	-	1,092,500	(1,092,500)
D1.1.7	Planet vjetore për zhvillimin e AFP-së të miratuara në përputhje me Planin e Veprimit të SKPA-së dhe raportimi i siguruar i progresit.	10550	MFE/AKPA		I 2020	IV 2022	1,830,000	-	1,092,500	(262,500)
D1.2	Fuqizimi i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK).	9240	MFE/AKAFPK	DAP/ASPA	IV 2019	I 2021				
D1.2.1	Struktura dhe funksionet e AKAFPK-së të miratuara në kuadrin ligjor përkatës.	9240	MFE/AKAFPK		IV 2019	I 2020	147,615	200,000	-	(52,385)
D1.2.2	Stafi i AKAFPK-së i rekrutuar sipas strukturës dhe organogramës së re, si dhe për aplikimin dhe menaxhimit të projekteve të financuara nga programet e BE-së (EaSI, Erasmus+ etj.).	9240	MFE/AKAFPK	DAP	I 2020	IV 2020	71,745,370	300,000	-	51,006,330
D1.2.3	Buxheti i alokuar sipas funksioneve të institucionit.	9240	MFE/AKAFPK		I 2020	IV 2020	148,400	200,000	-	(51,600)
D1.2.4	Stafi i trajnuar në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë.	9240	MFE/AKAFPK	ASPA	II 2020	I 2021	364,917	364,000	16,387,500	(10,924,083)
D1.3	Krijimi i një Fondi Social të Punësimit funksional(FSP).	10550	MFE/AKPA		IV 2019	IV 2022				
D1.3.1	Përbërja, kriteret dhe detyrat e Bordit të Administrimit të Fondit, të miratuara.	10550	MFE/AKPA		IV 2019	II 2020	1,998,800	-	1,092,500	906,300
D1.3.2	Mënyra e përdorimit të Fondit Social të Punësimit të miratuar.	10550	MFE/AKPA		II 2020	IV 2022	1,636,344	-	7,647,500	(6,011,156)
D1.3.3	Sekretariati i FSP i ngritur.	10550	MFE/AKPA		I 2020	II 2020	545,448	-	-	545,448



D1.3.4	Kapacitetet për funksionimin dhe zbatimin e FSP të ngritura.	10550	MFE/AKPA		I 2020	III 2020	804,540	-	-	804,540
D1.3.5	Fushatë promovuese për risitë e ligjit të nxitjes lidhur me PAK.	10550	MFE/AKPA		IV 2019	II 2020	578,181	-	-	578,181
D1.3.6	Krijimi i rrjetit të OJF-ve lidhur me fokusimin të PAK.	10550	MFE/AKPA		I 2020	III 2020	68,181	-	-	68,181
D1.4	Rishikim i skemave të financimit dhe buxhetimit në nivel ofruesi të AFP-së.	9240	MFE/AKAFFPK		IV 2019	III 2020				
D1.4.1	Kuadri ligjor për menaxhimin financiar të ofruesve të AFP-së i miratuar dhe në zbatim.	9240	MFE/AKAFFPK		IV 2019	II 2020	502,740	452,000	-	50,740
D1.4.2	Procedurat e miratuara e të zbatuara për aplikimin e skemave të financimit, përfshirë të ardhurat e veta.	9240	MFE/AKAFFPK		III 2020	III 2020	125,685	300,000	-	(174,315)
D1.4.3	Udhëzues dhe instrumente të tjera mbështetëse për zbatimin e procedurave financiare.	9240	MFE/AKAFFPK		III 2020	III 2020	251,370	251,000	-	370
D1.5	Forcimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të politikëbërjes në sektorin e punësimit dhe të AFP-së.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAFFPK		I 2020	IV 2022				
D1.5.1	Dokumentë metodologjik i hartuar.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAFFPK		I 2020	III 2020	718,452	226,000	2,731,250	(2,238,798)
D1.5.2	Raporte periodike për matjen e eficientës së programeve aktive të tregut të punës, formimit profesional, AFP-së dhe shërbimeve të punësimit.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAFFPK		I 2020	IV 2022	2,212,080	1,581,000	10,378,750	(6,489,420)
D1.5.3	Kapacitetet vlerësuese dhe monitoruese të zhvilluara.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAFFPK		III 2020	IV 2022	1,387,131	1,581,000	-	73,131
D2.	OBJEKTIVI SPECIFIK: Fuqizimi i rolit të dialogut social në qeverisjen e tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve profesionale.		Drejtues	Pjesëmarrësit						
D2.1	Konsolidimi i rolit të Këshillit Kombëtar të Punës.	1110	MFE		I 2019	IV 2022				
D2.1.1	Raport vlerësimi për aktivitetin 3-vjeçar të KKP-së.	1110	MFE		I 2019	IV 2022	10,585,424	-	-	8,022,704
D2.1.2	Rregullorja për funksionimin e KKP-së e rishikuar dhe e miratuar.	1110	MFE		II 2021	IV 2021	250,908	-	-	250,908
D2.1.3	VKM për kriteret e përfaqësueshmërisë i miratuar.	1110	MFE		II 2019	I 2020	250,908	-	-	250,908
D2.1.4	Mekanizmi për zbatimin e rekomandimeve të KKP-së i miratuar dhe funksional.	1110	MFE		III 2019	I 2020	250,908	-	-	250,908
D2.1.5	Këshilli Kombëtar i Punës i rikonstituar pas përfundimit të mandatit në bazë të kriterëve të reja.	1110	MFE		IV 2020	I 2021	167,272	-	-	167,272
D2.2	Fuqizimi i rolit të Këshillit Kombëtar të AFP-së.	9240	MFE/AKAFFPK		IV 2019	IV 2022				
D2.2.1	Kuadri ligjor për ngritjen dhe funksionimin e KKAFFP-së i miratuar.	9240	MFE/AKAFFPK		IV 2019	IV 2019	108,410	108,000	-	410
D2.2.2	KKAFFP i ngritur dhe funksional.	9240	MFE/AKAFFPK		IV 2019	IV 2022	478,092	200,000	-	298,092
D2.2.3	Komisionet teknike ad hoc të ngritura dhe funksionale.	9240	MFE/AKAFFPK		I 2020	IV 2022	452,466	300,000	-	252,466
D2.2.4	Sekretariati Teknik funksional.	9240	MFE/AKAFFPK		IV 2019	IV 2022	1,078,192	600,000	-	378,192
D2.2.5	Kapacitetet e KKAFFP-së dhe të Sekretariatit Teknik të fuqizuara.	9240	MFE/AKAFFPK		I 2020	IV 2022	104,322	200,000	-	(29,011)
D2.3	Fuqizimi i dialogut social për kontratat kolektive dhe mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve.	1110/10550	MFE/AKPA	Partnerët socialë/ISHPSHS	I 2019	I 2020				
D2.3.1	Databaza kombëtare e ngritur dhe e aksesueshme.	1110/10550	MFE/AKPA	Partnerët socialë/ISHPSHS	II 2019	IV 2019	250,908	-	-	250,908
D2.3.2	Rrjeti shtetëror i ndërmjetësimit dhe pajtimit i ngritur.	1110/10550	MFE/AKPA	Partnerët socialë/ISHPSHS	I 2019	IV 2019	2,068,080	-	-	2,068,080
D2.3.3	Sistemi informatik i regjistrimit të mosmarrëveshjeve i ngritur dhe funksional.	1110	MFE	Partnerët socialë/ISHPSHS	III 2019	I 2020	501,816	-	-	501,816
D2.3.4	Kapacitetet e rrjetit shtetëror të ndërmjetësimit dhe pajtimit të ngritura.	1110	MFE	Partnerët socialë/ISHPSHS	III 2019	IV 2019	20,909	-	-	20,909
D3.	OBJEKTIVI SPECIFIK: Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të informacionit të tregut të punës dhe AFP-së që garanton të dhëna të sigurta dhe të përditësuara.		Drejtues	Pjesëmarrësit						
D3.1	Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi kombëtar të informacionit të tregut të punës dhe AFP-së.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAFFPK	INSTAT SHSSH	IV 2019	IV 2022				
D3.1.1	Sistemi i informacionit të tregut të punës dhe AFP-së i konceptuar.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAFFPK	INSTAT SHSSH	IV 2019	I 2020	1,066,252	6,062,000	15,773,850	(20,769,598)
D3.1.2	Sistemi i informacionit për tregun e punës dhe AFP-në i ngritur në Ministri.	1110	MFE	INSTAT	I 2020	III 2020	100,548	-	-	100,548



D3.1.3	Sistemi i informacionit të tregut të punës funksional në bazë të aplikacioneve që bëjnë lidhjen e informacionit.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAAPK	INSTAT	IV 2020	IV 2020	39,000,000	65,000,000	-	(26,000,000)
D3.1.4	Informacione të përditësuara të tregut të punës dhe AFP-së të koordinuara ndërmjet institucioneve.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAAPK	INSTAT SHSSH	IV 2020	IV 2022	2,500,000	4,000,000	-	(1,166,667)
D3.1.5	Buletine periodike me informacion për tregun e punës dhe AFP-në.	9240/10550	MFE/AKPA/AKAAPK	INSTAT SHSSH	IV 2020	IV 2022	-	3,000,000	4,370,000	(5,277,500)
D3.2	Konsolidimi i mekanizmeve për parashikimin e aftësive për kualifikime në treg, në nivel sektorial, kombëtar dhe lokal.	10550	MFE/AKPA	INSTAT	IV 2020	IV 2022				
D3.2.1	SNA periodike dhe vlerësime të tjera.	10550	MFE/AKPA	INSTAT	IV2020	IV 2022	2,761,280	-	3,277,500	(516,220)
D4.	OBJEKTIVI SPECIFIK: Zhvillimi dhe zbatimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.		Drejtues	Pjesëmarrësit						
D4.1	Mirëmbajtja e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale.	9240	MFE/AKAAPK	MASR/Task-forcë KSHK	IV 2019	IV 2022				
D4.1.1	Kuadri ligjor për zbatimin e KShK-së i plotësuar.	9240	MFE/AKAAPK	MASR/ Task-forcë KSHSK	IV 2019	IV 2022	538,308	1,526,000	-	(606,193)
D4.1.2	Kualifikimet profesionale të reja / të rishikuara sipas nevojave të tregut të punës (në bazë të analizës së nevojave për aftësi).	9240	MFE/AKAAPK	Task-forcë KSHK	IV 2019	IV 2022	37,419,828	28,000,000	15,046,700	(7,826,872)
D4.1.3	Sistemi i vlerësimit dhe certifikimit të kualifikimeve i përmirësuar.	9240	MFE/AKAAPK	Task-forcë KSHK	IV 2019	IV 2020	11,399,703	5,000,000	1,092,500	5,307,203
D4.1.4	Sistemi i krediteve në AFP i konceptuar në përputhje ECET.	9240	MFE/AKAAPK	Task-forcë KSHK	IV 2020	IV 2022	682,384	8,000,000	-	(4,700,949)
D4.1.5	Mekanizmi për përfshirjen e kualifikimeve joformale në KShK dhe stafi i AKAAPK-së për zbatimin e këtij mekanizmi.	9240	MFE/AKAAPK	Task-forcë KSHK	IV 2020	IV 2022	2,084,576	1,500,000	-	1,034,576
D4.1.6	Strategjia e komunikimit dhe plani i veprimtë KShK-së i hartuar.	9240	MFE/AKAAPK	Task-forcë KSHK	II 2020	III 2021	314,912	-	-	(2,997,588)
D4.1.7	Raporti i referencimit i përfunduar.	9240	MFE/AKAAPK	Task-forcë KSHK	IV 2019	I 2021	926,460	600,000	5,462,500	(5,136,040)
D4.2	Ngritja dhe funksionimi i Komiteteve Sektoriale.	9240	MFE/AKAAPK		IV 2019	IV 2022				
D4.2.1	Kuadri ligjor për ngritjen dhe funksionimin e komiteteve sektoriale i plotësuar.	9240	MFE/AKAAPK		IV 2019	IV 2022	393,640	2,500,000	-	(1,481,360)
D4.2.2	1 Komitet Sektorial në një sektor të identifikuar i pilotuar.	9240	MFE/AKAAPK		IV 2019	IV 2020	582,209	400,000	-	182,209
D4.2.3	Mekanizmat e funksionimit të KS dhe kualifikimet profesionale të validuara në një sektor të pilotuar.	9240	MFE/AKAAPK		I 2020	IV 2020	1,069,350	4,000,000	5,462,500	(8,393,150)
D4.2.4	Raporti i sektorëve të identifikuar.	9240	MFE/AKAAPK		I 2021	II 2021	214,483	2,000,000	-	(1,785,517)
D4.2.5	Ngritja e Komitetit Sektorial në sektorin e dytë të identifikuar.	9240	MFE/AKAAPK		II 2021	IV 2022	5,900,000	6,000,000	-	(1,080,000)
D5.	OBJEKTIVI SPECIFIK: Legjislacioni kombëtar që rregullon qeverisjen e tregut të punës është në përputhje me synimet e vendit për zhvillim social ,ekonomik dhe integrim, si dhe me direktivat e Bashkimit Evropian.		Drejtues	Pjesëmarrësit						
D5.1	Përafrimi i legjislacionit përkatës shqiptar me Direktivat e BE-së.	10550	MFE/AKPA	MSHMS/ MB	III 2019	IV 2022				
D5.1.1	Analiza e hendeut ligjor dhe institucional për kapitujt e BE-së e kryer	10550	MFE/AKPA	MSHMS/ MB	III 2019	IV 2019	1,129,545	-	2,731,250	(1,055,455)
D5.1.2	Legjislacioni i përafruar i miratuar	10550	MFE/AKPA	MSHMS/ MB	III 2019	IV 2022	15,060,600	-	-	15,060,600



Pasaporta e Treguesve te Strategjise Kombetare per Punesim dhe Aftesi 2019-2020

Pasaporta e indikatoreve

[illegible]

**UDHËZIM****Nr. 22, datë 4.10.2019****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 2.8.2013,
TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE
SHKENCËS, “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E QEVERISË SË
NXËNËSVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe nenit 36, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 25, datë 2.8.2013, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Nënkreu IV, i kreut 1, ndryshon si më poshtë:

“IV. Detyrat e qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve ka për detyrë:

a) të organizojë veprimtari nëpërmjet të cilave nxënësve t’u jepet mundësia të dëgjohen nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollës për idetë në të mirë të tyre dhe të shkollës;

b) të organizojë veprimtari të nxënësve në dobi të shkollës;

c) të organizojë veprimtari që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset vendimmarrëse;

d) të organizojë veprimtari që edukojnë vlera dhe qëndrime demokratike;

e) të kontribuojë në krijimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës–nxënës, nxënës–mësues;

f) të kontribuojë në parandalimin dhe pakësimin e abuzimit të nxënësve me duhanin, alkoolin dhe drogat, bulizmin, si dhe të braktisjes së shkollës;

g) të kontribuojë në ndërgjegjësimin e nxënësve për problemet sociale brenda dhe jashtë shkollës;

h) të aftësojë nxënësit për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshet grup-mosha e tyre;

i) të zgjedhë një herë në dy vjet nxënësit e shkollës, që do të kandidojnë për Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë, nga kuotat e përcaktuara për kategoritë e veçanta të nxënësve.”.

2. Në fund të titullit të nënkreut I, të kreut 2, hiqet togfjalëshi “dhe përbërja e saj”. Gjithashtu, pas pikës 8 të këtij nënkreu, shtohet pika 9, me përmbajtje si më poshtë:

“9. Kryetari i qeverisë së nxënësve duhet të përzgjidhet nga klasat 4–8 për arsimin bazë, ndërsa për arsimin e mesëm të lartë nga klasat 10–11, për të fituar të drejtën të kandidojë në zgjedhjet e Parlamentit të Nxënësve të Shqipërisë.”.

3. Pas nënkreut I, të kreut 2, shtohet nënkreu I/1, me përmbajtje si më poshtë:

“I/1. Përbërja e qeverisë së nxënësve

1. Qeveria e nxënësve ka kryetarin dhe sekretarin e saj.

2. Qeveria e nxënësve përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga nxënësit në bazë klase apo klasash paralele, sipas procedurave të parashikuara në nënkreun I të këtij kreu.

3. Kryetari i qeverisë së nxënësve:

a) drejton veprimtarinë e qeverisë së nxënësve;

b) drejton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të qeverisë së nxënësve;

c) drejton hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të qeverisë së nxënësve;

d) është përfaqësuesi i nxënësve në bordin e shkollës;

e) përfaqëson nxënësit e shkollës në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë saj;

f) shkarkohet nga detyra prej drejtorit të shkollës në rast të thyerjes së rregullores së brendshme të shkollës dhe legjislacionit në fuqi.

4. Sekretari i qeverisë së nxënësve:

a) zgjidhet me shumicë votash në mbledhjen e parë të qeverisë së nxënësve;

b) përgatit materialet që do të shpërndahen në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;

c) mban shënimet e mbledhjeve të qeverisë së nxënësve;

d) lajmëron anëtarët e qeverisë së nxënësve dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës;

e) mban arkivin e qeverisë së nxënësve në një mjedis të institucionit.

5. Anëtari i qeverisë së nxënësve:

a) komunikon mendimet e nxënësve që përfaqëson, në qeverinë e nxënësve;

b) përcjell vendimet e qeverisë së nxënësve te klasa që përfaqëson;

c) propozon nisma ose veprimtari, që mund të organizohen në nivel shkolle;



d) merr pjesë rregullisht dhe është aktiv në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;

e) raporton në çdo mbledhje të kryetari i qeverisë së nxënësve.”.

4. Nënkreu III, i kreut 2, ndryshohet si më poshtë:

“III. Veprimtari të qeverisë së nxënësve

Qeveria e nxënësve:

1. merr nisma për veprimtari jashtëkurrikulare jopolitike të nxënësve dhe i organizon ato në bashkëpunim me drejtorin e shkollës;

2. përgatit dhe realizon projekte, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, për plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve;

3. përgatit dhe realizon projekte, pas miratimit të drejtorit të shkollës, edhe me organizata jofitimprurëse, të cilat kanë në fokusin e tyre të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje dhe arsim;

4. zhvillon pyetësorë mbi kënaqësinë e nxënësve për shërbimin që shkolla siguron ose për aspekte të veçanta të jetës shkollore të nxënësve;

5. bashkëpunon me strukturat homologe të shkollave të tjera, brenda ose jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;

6. komunikon në mënyrë të vazhduar për veprimtarinë e saj me këshillin e prindërve;

7. harton planin vjetor, mbi bazën e përparësive të identifikuara nga të gjitha klasat e shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

UDHËZIM

Nr. 23, datë 14.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015 “PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, emërtimi “Agjencia Kombëtare e Provimeve” zëvendësohet me emërtimin “Qendra e Shërbimeve Arsimore”.

b) Shtojca nr.1 në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin Parauniversitar dhe Njësitë arsimore vendore.



Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

SHTOJCA NR. 1

Formimi i numrit unik të lejes për ushtrimin e profesionit të mësuesit.

1 4 0 1 0 0 0 0 1

Viti, Kodi i Profilit, numri individual

Viti: përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë vitin e dhënies së provimit të shtetit.

Kodi i profilit: përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë kodin e profilit.

Numri individual: përbëhet nga gjashtë shifra të cilat tregojnë numrin individual të kandidatit duke filluar nga 000001 dhe vazhdojnë në rend rritës.

Kodi sipas çdo profili në profesionin e mësuesit:

1. Gjuhë angleze, kod 01;
2. Gjuhë italiane kod 02;
3. Gjuhë frënge kod 03;
4. Gjuhë gjermane kod 04;
5. Gjuhë greke kod 05;
6. Gjuhë shqipe dhe Letërsi kod 06;
7. Shkenca sociale kod 07;
8. Histori kod 08;
9. Gjeografi kod 09;
10. Histori-Gjeografi kod 10;
11. Histori-Gjeografi, Edukatë kod 11;
12. Matematikë kod 12;
13. Fizikë kod 13;
14. Matematikë-Fizikë kod 14;
15. Informatikë kod 15;
16. Matematikë-Informatikë kod 16;
17. Kimi, kod 17;
18. Biologji kod 18;
19. Biologji-kimi kod 19;
20. Edukim fizik kod 20;
21. Arte figurative kod 21;
22. Muzikë kod 22;
23. Arsime fillor kod 23;
24. Arsime special kod 24.

UDHËZIM

Nr. 6, datë 14.10.2019

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 2.4.2019, “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHTETËRORE, PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS- KANALIZIMEVE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)”,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 8/a, të lidhjes 1, “Metodologji për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve”, të shtohet paragrafi:

“Me vendim të Këshillit Bashkiak, për nevoja emergjente të shoqërisë, për të mos penguar funksionimin normal të aktivitetit të saj, mund të bëhet ndryshim i destinacionit të përdorimit të subvencionit, brenda zërave të kostos direkte të operimit”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të gjitha bashkitë dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

**UDHËZIM****Nr. 30, datë 16.10.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 5, DATË 15.4.2016
“PROCEDURAT E PËRLLOGARITJES SË
PËRFITIMEVE NGA LIGJET E
MËPARSHME DHE TË PAGESAVE TË
DËMSPËRBLIMIT PËR ISH-TË
DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT
KOMUNIST, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 11, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 14.4.2011 “Për miratimin e afateve dhe skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1253, datë 2.7.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të vlerësimit për dëmshpërblimin e përfituar nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5, datë 15.4.2016, “Procedurat e përllogaritjes së përfitimeve nga ligjet e mëparshme dhe të pagesave të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në paragrafin III, “Procedurat dhe përgjegjësitë për shpërndarjen e dëmshpërblimit financiar të ish-të dënuarve politikë të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave”, pikat 2, 3 dhe 4 ndryshojnë me këtë përmbajtje:

“2. Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë”.

“3. Për të gjitha subjektet përfituese parësore, kur vlera totale e dëmshpërblimit është mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, do të vijohet me pagesën e kështit pasardhës deri në shpërndarjen e plotë të shumës së miratuar”.

“4. Në rast se vlera totale e miratuar për të gjithë përfituesit është deri në 1 000 000 (një milion) lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit do të kryhet me një kësht të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit. Me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit, për të gjithë përfituesit, brenda kështit më të ulët, fillon pagesa e kështit pasardhës. Ky mekanizëm do të përsëritet deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.”.

2. Kudo në përmbajtjen e udhëzimit, emërtimet “Ministria e Financave”, “ministri i Financave”, zëvendësohen përkatësisht me togfjalëshin “ministria përgjegjëse për financat” dhe “ministri përgjegjës për financat”.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT**Nr. 5749/5, datë 10.9.2019**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMEVE PORTUALE TË PORTIT
TË LLOJIT MBM NË PORTO ROMANO,
DURRËS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 84, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 1, pika 34 dhe nenit 14, i ligjit nr. 104/2015, datë 23.9.2015, “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncensionare “Porti MBM” (*Multy Buoy Mooring*) dhe ligji nr. 7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, i ndryshuar, ministri i



Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

Kufiri maksimal i tarifave kryesore që do të përdoren nga Porti i llojit MBM në Porto Romano janë si më poshtë:

KAPITULLI 1 TË PËRGJITHSHME

1. Përkufizime

a) “Tarifë shërbimi” do të thotë tarifat që aplikohen për çdo shërbim të kryer në përputhje me këtë udhëzim;

b) “Pronar” do të thotë agjenti, marrësi me qira (Charter) ose zotëruesi i anijes;

c) “Port” do të thotë porti i llojit MBM i shpallur si port i hapur për trafik ndërkombëtar me vendimin e KM-së nr. 230, datë 17.4.2019 “Për shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës ‘Port i hapur për trafik ndërkombëtare’ detar dhe i organizuar sipas kuadrit ligjor në fuqi;

ç) “Pritësi i Mallit” do të thotë personi i cili ka porositur mallin që përpunohet duke përdorur terminalin e hidrokarbureve Porti MBM;

d) Pronar do të thotë agjenti, marrësi me qira (Charter) ose zotëruesi i anijes;

dh) “Certifikata e madhësisë së tonazhit” do të thotë një certifikatë e lëshuar nga një autoritet i matjes i njohur nga Autoriteti Detar, i cili vendos tonazhin e regjistruar bruto (GT) dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen;

e) “Tarifat e ngarkim-shkarkimit” për produktet e listuar më poshtë nënkupton tarifën për përpunimin e transportit të lëndëve djegëse duke përdorur linjën teknologjike nga anija cisternë te magazina e pritësit të mallit dhe anasjelltas. Në rastet e shkarkimit të mallit nga anija për te magazina kjo tarifë i faturohet pritësit të mallit, në rastet e ngarkimit të anijes nga magazina tarifa i faturohet nisësit të mallit;

f) “Tarifa Wharefage dhe e Transferimit” është tarifë për lidhjen dhe nisjen e transferimit të lëndëve djegëse nga anija cisternë në linjën e tubacionit transferues të Portit MBM. Kjo tarifë i faturohet pritësit të mallit;

g) “Tarifa e Sigurisë (Port Security)” është tarifë që i aplikohet pritësit të mallit për sigurinë e të gjithë territorit të Portit, veçanërisht linjës së transferimit të lëndëve djegëse për vetë faktin që këto lëndë përbëjnë rrezikshmëri të lartë;

gj) “Tarifë e mbrojtjes kundër zjarrit” është tarifë që i aplikohet pritësit të mallit në çdo rast gjatë procesit të ngarkim shkarkimit për përdorimin e sistemit të detektimit të gazrave dhe flakës dhe reagimit në rast zjarri në mënyrë që operacioni i ngarkim shkarkimit të jetë sa më i sigurt;

h) “Tarifa e Pastrimit të linjës teknologjike” është një tarifë që i aplikohet pritësit të mallit për boshatisjen e tubacionit nga kalata akostuese deri te depozita e pritësit të mallit. Kjo procedurë kryhet në përfundim të çdo proces shkarkimi;

i) “Tarifa Administrative dhe Informimit” është tarifë që i aplikohet pritësit të mallit për krijimin e mundësisë që të survejojë procesin e ngarkim-shkarkimit dhe për informimin në kohë reale;

j) “Tarifa e parandalimit të ndotjes” është tarifë që i aplikohet pritësit të mallit për parandalimin e ndotjes mjedisore detare. Kjo tarifë ndahet në tarifë fikse për operacionin e hapjes apo mbledhjes së shiritave kufizues (Boomers), tarifë në bazë të gjatësisë së rrethimit të anijes dhe tarifë për ndërhyrjen në rastet kur ndotet porti dhe është e nevojshme ndërhyrja për pastrim me pajisje reaguese. Tarifa për ndërhyrjen paguhet vetëm kur ka incidente me pasojë ndotjen e detit dhe është e nevojshme përdorimi i pajisjeve reaguese;

k) “Tarifa e Kanalit” është tarifë që i aplikohet anijes e cila përdor kanalin e Portit MBM;

l) “Tarifa e Përdorimit të Kalatës” është tarifë që i aplikohet anijes e cila përdor kalatën e Porti MBM për t’u akostuar. Kjo tarifë është mbi baza ditore ose kur nuk është dita e plotë llogaritet vetëm për pjesën e ditës që ka përdorur kalatën;

m) “Tarifa për sigurinë e anijes (sipas Kodit ISPS)” është tarifë që i aplikohet anijes përgjatë qëndrimit në kalatën e Portit MBM.

2. Aplikime

Këto tarifa aplikohen për ato anije të cilat vijnë në, ose përdorin, Portin MBM;

b) Këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga qeveria shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.



3. Tarifat

Tarifat portuale duhet të llogariten sipas njësive që janë vendosur në tabelën e mëposhtme:

a) Detyrimet për portin të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë nga pronari ose agjenti i anijes në përputhje me

termat dhe kushtet e pagesës dhe mbledhen nga Porti Detar;

b) Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës portuale janë të pavarura (nuk kanë lidhje) nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

KAPITULLI 2

2.1 TARIFAT MAKSIMALE PËR SHËRBIMIN NË PORTIN MBM

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Valuta	Tarifa
1	Ngarkim-shkarkimi për 1 ton gazoil;	€	2.52
2	Ngarkim-shkarkimi për 1 ton benzinë;	€	5.04
3	Ngarkim-shkarkimi për 1 ton GLN;	€	5.04
4	Ngarkim-shkarkimi për 1 ton naftë bruto;	€	5.04
5	Ngarkim-shkarkimi për 1 ton karburant avionësh;	€	5.04
6	Ngarkim-shkarkimi për 1 ton solar, mazut ose bitum;	€	8.2
7	Ngarkim-shkarkim për 1 ton lëngje ushqimore për biokarburante (vajra, alkool etj.);	€	7.2
8	Ngarkim-shkarkim për 1 ton varja lubrifikues dhe bazike (sintetike);	€	7.2
9	Transferim për 1 ton diesel nga anija në anije;	€	1.60
10	Tarifa <i>wharfage</i> dhe e transferimit për ton ngarkesë (sipas B/L);	€	0.12
11	Tarifa e sigurisë (Port Security), për 1 ton;	ALL	51
12	Shërbimi i mbrojtjes ndaj zjarrit, për 1 orë;	ALL	5000
13	Pastrimi i linjës me azot;	€	350
14	Tarifa administrative dhe e informimit:		
	20001-30000 TONË	€	600
	Për çdo 500 tonë ngarkesë shtesë sipas BL apo fraksion të tij aplikohet shtesë	€	200
15	Tarifa për mbrojtjen e mjedisit detar:		
1	Tarifa për parandalimin e ndotjes;		
1.1	Hapja ose mbyllja e shiritit kufizues (boomer) për rrethimin e anijes;	€	250
1.2	Shtirirja e shiritit kufizues (boomer) për rrethimin e anijes/ për metër linear;	€	0.35
1.3	Lëvizja e anijes zjarrfikëse në asistencë gatishmërie (nga nisja deri kthim në bazë);	€	750



1.4	Kohë qëndrimi në gatishmëri anijes zjarrfikëse dhe operatorëve të saj/ për 1 orë;	€	65
2	Tarifa për reagimin ndaj ndotjes/ për një orë:		
2.1	Kompleti skimmer;	€	35
2.2	Pompat thithëse;	€	75
2.3	Shiritat kufizues (boomers 300 m);	€	75
2.4	Mjet i vogël lundrues;	€	30
2.5	Anija për tërheqjen e ujërave të ndotura;	€	85
2.6	Specialistët;	€	25
16	Tarifa e përdorimit të portit dhe kanalit /për GT;	€	0.18
17	Tarifa e përdorimit të kalatës/bovave për metër linear për një ditë/fraksion dite;	€	5.5
18	Shërbimi për sigurinë e anijes (<i>Ship Security</i>):		
	20001- 30000 G.T	€	500
	Për çdo 1000GT shtesë apo fraksion të tij aplikohet shtesë	€	200
19	Shërbimi i Ormexhimit:		
	20001-30000 GT	€	1000
	Për çdo 500GT Ton shtesë apo fraksion të tij aplikohet shtesë	€	500
20	Shërbimi për përdorim skafi;	€	35
21	Shërbimi për tërheqjen e mbetjeve nga anijet:		
1	Shërbimi për tërheqjen e mbetjeve të ngurta;		
	20001-30000 GT	€	260
	Për çdo 500GT tonë shtesë apo fraksion të tij aplikohet shtesë		45
	Kur shërbimi kryhet në radë, ose në fushën e bovave aplikohet shtesë	€	50%
2	Shërbimi për tërheqjen e mbetjeve të lëngëta		
	Për mbetjet vajore, sipas kërkesës	€	100
	Për çdo m ³ të tërhequr	€	Plus 50 euro
	Për ujërat e ndotura, sipas kërkesës	€	100
	Për çdo m ³ të tërhequr	€	Plus 35 euro
22	Tarifa e furnizimit me ujë të pijshëm (mbi çmimin (vlerën) e ujit të furnizuar)	€	Plus 40% të faturës
23	Tarifa e furnizimit me energji elektrike (mbi çmimin (vlerën) e faturës së energjisë elektrike)	€	Plus 30% të faturës
24	Furnizim me ushqime, karburant apo vajra	€	Plus 40% të faturës



KAPITULLI 3
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 559, datë 10.10.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES, MBI
VENDOSJEN E KRITEREVE PËR
PLANET KOMBËTARE PËR
PËRSHPEJTIMIN E ÇRRËNJOSJES SË
BRUCELOZËS, TUBERKULOZIT DHE
LEUKOZËS ENZOOTIKE NË GJEDHË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Mbi vendosjes e kriterëve për planet kombëtare për përshpejtimin e çrrënjosjes së brucelezës, tuberkulozit dhe leukozës enzootike në gjedhë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe të mbrojtjes së bimëve, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 298, datë 2.7.2008, për miratimin e rregullore “Mbi vendosjen e kriterëve për planet kombëtare për përshpejtimin e çrrënjosjes së brucelezës, tuberkulozit dhe leukozës enzotike në gjedhë”, shfuqizohet.

4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

RREGULLORE

**MBI VENDOSJEN E KRITEREVE PËR
PLANET KOMBËTARE PËR
PËRSHPEJTIMIN E ÇRRËNJOSJES SË
BRUCELOZËS, TUBERKULOZIT DHE
LEUKOZËS ENZOOTIKE NË GJEDHË**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kriteret e planit të çrrënjosjes së brucelezës, tuberkulozit dhe leukozës në gjedhë.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. Në rastin e brucelezës në gjedhë:

a) “Tufa e tipit B1”, është tufa në të cilën historia e rastit klinik, statusit të vaksinës e të serologjisë janë të panjohura;

b) “Tufa e tipit B2”, është tufa në të cilën historia e rastit klinik, statusit të vaksinës e të serologjisë janë të njohura dhe në të cilat testet rutinë të monitorimit, janë kryer në përputhje me planin vjetor kombëtar për kontrollin e brucelezës në gjedh për t’i kaluar këto tufa me status të tipit B3 ose B4;

c) “Tufa e tipit B3”, është tufa e lirë nga bruceleza sipas urdhrit të ministrit nr. 505, datë 7.12.2016 “Mbi problemet shëndetësore që prekin tregtinë e gjedhit dhe derrave”.

d) “Tufa e tipit B4”, është tufa zyrtarisht e lirë nga bruceleza, sipas urdhrit të ministrit nr. 505, datë 7.12.2016 “Mbi problemet shëndetësore që prekin tregtinë e gjedhit dhe derrave”.

2. Në rastin e tuberkulozit të gjedhit:

a) “Tufa e tipit T1”, është tufa në të cilën historia e rastit klinik dhe statusit të testit të tuberkulinës janë të panjohura;

b) “Tufa e tipit T2”, është tufa në të cilën historia e rastit klinik dhe statusit të testit të tuberkulinës janë të njohura dhe në të cilat testet rutinë të monitorimit janë kryer në përputhje me



planin vjetor kombëtar për kontrollin e turbekulozit në gjedh për t'i kaluar këto tufa me status të tipit T3;

c) “Tufa e tipit T3”, është tufa zyrtarisht e lirë nga tuberkulozi sipas urdhrorit të ministrit nr. 505, datë 7.12.2016 “Mbi problemet shëndetësore që prekin tregtinë e gjedhit dhe derrave”.

3. “Kafshë e dyshuar”, është çdo kafshë e llojit gjedh e cila shfaq shenja që tregojnë praninë e mundshme të tuberkulozit, brucelozës ose leukozës enzotike të gjedhit dhe për të cilën një diagnozë e përshtatshme nuk ka konfirmuar zyrtarisht asnjëherë e as përjashtuar zyrtarisht praninë e një ose më shumë prej këtyre sëmundjeve.

4. “Mjete transporti”, janë automjete, trena, avionë me drejtim ngarkimi, anije e kontejnerë për transport në tokë, det e ajër.

KREU II MASA TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Masat e marra nga Autoriteti Kompetent

Për të garantuar që përshpejtimi i çrrënjësjes së sëmundjes është plotësisht efektiv Autoriteti Kompetent siguron zbatimin e të gjitha masave nga pika 1 deri në pikën 3 të këtij neni.

Masat e marra do të jenë:

1. Regjistrimi i popullatës kombëtare të gjedhit, i cili është subjekt për çrrënjësjen dhe masat parandaluese duhet të zbatohet me qëllim që të gjithë gjedhët të mund të vendosen nën kontrollin monitorues sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Kompensimi për kafshët e therura të bëhet sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 8.5.2013, “Për dëmshpërblimin e kafshëve të eliminuara”, e ndryshuar.

3. Zbatimi sistematikisht i masave të parashikuara për luftimin e sëmundjeve enzootike.

Neni 4

Identifikimi dhe regjistrimi i fermave me gjedh

1. Autoriteti Kompetent me qëllim monitorimin zyrtar të lëvizjes së kafshëve, siguron nëpërmjet shërbimit veterinar rajonal që gjedhët janë të regjistruar dhe identifikuar në mënyrë të përhershme.

2. Autoriteti Kompetent mban dhe përditëson, për secilën prej sëmundjeve, për të cilat ka një plan çrrënjësjeje, një regjistër zyrtar me të dhëna, për tufat e gjedhit të mbuluara nga një plan i tillë, klasifikuar në përputhje me gjendjen e tyre shëndetësore.

KREU II MASA SPECIFIKE LIDHUR ME BRUCELOZËN NË GJEDH

Neni 5

Lajmërimi, ndalimi i trajtimit dhe profilaksia e sëmundjes

1. Prania ose dyshimi për praninë e brucelozës është detyrues dhe menjëherë e lajmërueshme te shërbimi veterinar rajonal nga pronari ose kujdestari i kafshës, teknikët veterinar, çdo mjek veteriner, drejtuesit e njërive të vetëqeverisjes vendore, punonjësit e shërbimit pyjor dhe gjuetarët.

2. Ndalohet çdo trajtim terapeutik për brucelozën.

3. Nëse praktikohet, vaksinimi kundër brucelozës, të kryhet nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar por të ndërpritet sa më shpejt të jetë e mundur që tufat të mund të kalojnë në statusin e tufave zyrtarisht të lira nga bruceloza.

Neni 6

Masat e marra në rast dyshimi dhe konfirmimi të sëmundjes

1. Në një tufë që ka një kafshë të dyshuar për brucelozë, shërbimi veterinar rajonal siguron që hetimet zyrtare të kryhen sa më shpejt të jetë e mundur për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e kësaj sëmundjeje. Në pritje të rezultatit të këtyre kontrolleve, shërbimi veterinar rajonal urdhëron zbatimin e masave të mëposhtme:

a) që tufa të vendoset nën mbikëqyrjen zyrtare;

b) të ndalohet çdo lëvizje brenda apo jashtë tufës, ose vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar me qëllim për therje pa vonesë. Në rastin e gjedhëve të kastruar, lëvizja mund të autorizohet nga veterineri zyrtar pas izolimit të kafshëve të dyshuara, nëse kafshët e kastruara lëvizin për në tufa majmërie dhe që andej në thertore;

c) kafshët e dyshuara brenda fermës të izolojnë.



2. Masat e referuara në pikën 1 të këtij neni nuk do të hiqen derisa prania ose dyshimi për praninë e brucelozës në tufën përkatëse të jetë zyrtarisht e përjashtuar.

3. Atje ku prania e brucelozës është konfirmuar zyrtarisht në një tufë, shërbimi veterinar rajonal merr masa të përshtatshme për të parandaluar përhapjen e sëmundjes dhe siguron në veçanti që:

a) të gjitha lëvizjet hyrje apo dalje për tufën në shqyrtim janë të ndaluara, veçse me autorizim nga veterineri zyrtar për qëllime therje të menjëhershme. Në rastin e gjedhëve të kastruar, lëvizja mund të autorizohet nga veterineri zyrtar pas izolimit të kafshëve të dyshuara, nëse kafshët e kastruara lëvizen për në tufa majmërie dhe që andej në thertore;

b) kafshët në të cilat është konfirmuar zyrtarisht prania e brucelozës dhe kafshët të cilat mund të kenë qenë infektuar prej tyre të jenë izoluar në tufë;

c) kafshët në të cilat prania e brucelozës është konfirmuar zyrtarisht, kafshët të cilat janë ekzaminuar siç përcaktohet në nenin 21, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kanë rezultuar pozitiv, dhe kafshët e konsideruara nga shërbimi veterinar rajonal si të infektuara janë izoluar dhe identifikuar deri në therjen sipas përcaktimit të nenit 7 të kësaj rregullore;

d) qumështi i lopëve të infektuara mund të përdoret vetëm për ushqim kafshësh në të njëjtën fermë pas një trajtimi të përshtatshëm me nxehtësi;

e) qumështi nga lopët e një tufe të infektuar mund të dërgohet për përpunim, vetëm nëse i nënshtrohet një trajtimi të përshtatshëm me nxehtësi, në përputhje me ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

f) karkasat, gjysmëkarkasat, çerekët e karkasës, pjesë dhe të brendshme nga kafshët e infektuara të destinuara për përdorim si ushqim për kafshët të jenë trajtuar në mënyrë të tillë që shmang kontaminimin;

g) fetuset, viçat e lindur të ngordhur, viçat që kanë ngordhur nga bruceleza pas lindjes ose placentat janë asgjësuar në mënyrë të sigurt dhe shkatërrohen menjëherë, përveç rasteve kur duhen ekzaminuar;

gj) kashtat, shtrojat ose çdo material apo lëndë, e cila ka qenë në kontakt me lopët të infektuara, viça

ose placenta, është shkatërruar menjëherë, djegur apo groposur pasi janë lagur me disinfektant;

j) rregulloret zyrtare për kontrollin e stabilimenteve të tilla, si impiantet e eliminimit të karkasave, sigurojnë që atje nuk ka rrezik që materialet e prodhuara të përhapin brucelozën;

h) plehu nga stallat ose tjetër strehim i përdorur për kafshët është magazinuar në një vend të pa arritshëm për kafshët e fermës, i trajtuar me dezinfektantët e përshtatshëm dhe magazinuar për të paktën 3 javë; përdorimi i disinfektantëve nuk kërkohet nëse plehu është i mbuluar me një shtresë plehu të pa infektuar ose dheu. Mbeturinat e lëngëta nga stallat ose tjetër vend i përdorur për kafshët duhet të dezinfektohen nëse ai nuk është mbledhur në të njëjtën kohë me plehun.

Neni 7

Eliminimi i kafshëve pozitive

Shërbimi veterinar rajonal siguron që, pas ekzaminimit bakteriologjik, patologjik ose serologjik kafshët në të cilat prania e brucelozës është konfirmuar zyrtarisht janë therur nën mbikëqyrjen zyrtare sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 30 ditë pasi pronari ose kujdestari i tyre janë njoftuar zyrtarisht për rezultatet dhe për detyrimin e tij, sipas planit të çrrënjësjes, për të therur gjedhët në fjalë brenda kësaj kohe limit.

Neni 8

Ripopullimi i ambienteve të kafshëve, kullotave dhe dezinfektimi i mjeteve të transportit

Shërbimi veterinar rajonal siguron që:

1. Pas therjes së gjedhëve referuar përcaktimit të nenit 7 të kësaj rregullore dhe para ripopullimit strehimet, të tjera vend qëndrime tufash, të gjithë kontejnerët, pajisjet dhe të tjerë artikuj të përdorur për kafshët janë pastruar dhe dezinfektuar nën mbikëqyrjen zyrtare, në përputhje me instruksionet e dhëna nga veterineri zyrtar. Ripërdorimi i kullotave të cilat kanë pasur këto kafshë nuk duhet të bëhet për 60 ditë pas largimit nga kullota të tilla. Megjithatë, shërbimi veterinar rajonal, mund të heqë këto bllokime në rast të kafshëve të kastruara, me kusht që këto kafshë të lënë këto kullota vetëm



për therje ose kur lëvizin për në tufa majmërie dhe pastaj për në thertore;

2. Të gjitha mjetet e transportit, kontejnerët dhe pajisjet janë pastruar e dezinfektuar pas transportit të kafshëve nga tufa e infektuar, ose materiale, lëndë të cilat kanë qenë në kontakt me të tilla kafshë. Ambienti i ngarkimit për të tilla kafshë duhet pastruar dezinfektuar pas përdorimit;

3. Dezinfektantët që do të përdoren dhe koncentrimi i tyre të jenë të regjistruar nga Autoriteti Kompetente.

Neni 9

Kufizimi i lëvizjes së kafshëve në tufa

Shërbimi veterinar rajonal pas therjes së gjedhëve sipas përcaktimit të nenit 7, të kësaj rregullore përveç masave të përcaktuara në nenin 11, të kësaj rregullore siguron që:

1. Asnjë gjedh nuk mund të largohet nga tufa përkatëse veçse me autorizim të dhënë nga veterineri zyrtar, për qëllim therje të menjëhershme; megjithatë veterineri zyrtar mund të autorizojë lëvizjen e kafshëve të kastruara në fermë, me kusht që kafshët e kastruara lëvizin për në tufa majmërie dhe pastaj për në thertore.

2. Testet për brucelozë janë kryer në tufën në shqyrtim për të konfirmuar që sëmundja është eliminuar.

3. Tufa nuk plotësohet me kafshë për riprodhim derisa kafshët mbi 12 muaj të mbetura në të, për këtë qëllim, kanë kaluar një ose disa ekzaminime serologjike zyrtare për brucelozë; megjithatë, për gjedhët, të cilët janë vaksinuar, këto teste të nevojshme nuk do të kryhen derisa ato të jenë 18 muaj.

Neni 10

Testet serologjike në tufat e gjedhit

Shërbimi veterinar rajonal siguron që testi serologjik zyrtar kryhet në tufat e tipit B1 dhe B2 deri në kohën kur ato bëhen tufa të tipit B3 ose tipit B4.

Neni 11

Lëvizja e kafshëve në tufat e tipit B1, B2, B3, B4

Shërbimi veterinar rajonal siguron që:

1. Të gjitha kafshët femra dhe të gjithë demat nga tipi i tufave B1 të jenë të destinuara për tipin e tufave B2:

a) nëse janë në moshë mbi 12 muaj, kanë kaluar një test zyrtar serologjik të miratuar, të kryer brenda 30 ditëve para lëvizjes dhe janë të shoqëruara me certifikatë për këtë qëllim nga veterineri zyrtar;

b) janë izoluar menjëherë sapo arrijnë moshën së paku 60 ditë dhe nëse janë më shumë se 12 muaj, kanë kaluar një tjetër test serologjik zyrtar të miratuar para pranimit në tufën e tipit B2.

2. Të gjitha kafshët femra dhe të gjithë demat nga tufat e tipit B2 të jenë të destinuara për një tjetër tufë të tipit B2:

a) nëse janë në moshë mbi 12 muaj, kanë kaluar një test zyrtar serologjik të miratuar të kryer brenda 30 ditëve para lëvizjes dhe janë të shoqëruara me certifikatë për këtë qëllim nga veterineri zyrtar;

b) gjatë zhvendosjes apo lëvizjes nuk bien në kontakt me kafshë nga tufa me status shëndetësor më të ulët.

3. Lëvizja e kafshëve midis tufave B3 dhe B4, kryhet duke pasur parasysh kërkesat e urdhrat të ministrit nr. 505, datë 7.12.2016, “Mbi problemet shëndetësore që prekin tregtinë e gjedhit dhe derrave”.

Neni 12

Masat zyrtare të kontrollit në fermat me brucelozë

Shërbimi veterinar rajonal siguron që:

1. Masat zyrtare të kontrollit janë kryer për parandalimin e rihyrjes së infeksionit nga burime të tjera infeksioni në një tufë ku brucelozja është eliminuar;

2. Të gjitha lëvizjet e gjedhëve në tufë dhe midis tufave, të mbuluara nga plani i çrrënjësjes, janë nën monitorimin zyrtar;

3. Të gjitha masat e kontrollit të lëvizjeve referuar paragrafit 2 të mësipërm të zbatohen përveç masave ekzistuese lidhur me lëvizjet brenda dhe jashtë tufave të lira dhe zyrtarisht të lira nga brucelozja.



KAPITULLI III
MASA SPECIFIKE LIDHUR ME
TUBERKULOZIN E GJEDHIT

Neni 13

**Lajmërimi për praninë ose dyshimin e
tuberkulozit**

1. Prania ose dyshimi për praninë e tuberkulozit është detyrues dhe menjëherë e lajmërueshme te shërbimi veterinar rajonal nga pronari ose kujdestari i kafshës, teknikët veterinar, çdo mjek veterinar, drejtuesit e njësive të vetëqeverisjes, punonjësit e shërbimit pyjor dhe gjuetarët.

2. Shërbimi veterinar rajonal siguron sipas planit për çrrënjosjen e tuberkulozit ndalimin e:

- a) çdo trajtimi terapeutik ose për ulje ndjeshmërie për tuberkulozin;
- b) vaksinimit kundër tuberkulozit.

Neni 14

**Masat e marra në rast dyshimi dhe
konfirmimi në tufë të tuberkulozit**

1. Në një tufë që ka një kafshë të dyshuar për tuberkuloz, shërbimi veterinar rajonal siguron që hetimet zyrtare të kryhen sa më shpejt të jetë e mundur për të konfirmuar ose përjashtuar praninë e kësaj sëmundje. Në pritje të rezultatit të këtyre kontrolleve, shërbimi veterinar rajonal urdhëron zbatimin e masave të mëposhtme:

- a) që tufa të vendoset nën mbikëqyrjen zyrtare;
- b) të ndalohet çdo lëvizje brenda apo jashtë tufës, ose vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar me qëllim për therje pa vonesë;
- c) kafshët e dyshuara brenda fermës të izoloohen.

2. Masat sipas pikës 1 nuk do të hiqen derisa prania apo dyshimi për praninë tuberkulozit në tufën përkatëse të jetë përjashtuar zyrtarisht.

3. Atje ku, prania e tuberkulozit është konfirmuar zyrtarisht, shërbimi veterinar rajonal do të marrë masa të përshtatshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjes dhe në veçanti që:

- a) të ndalohet çdo lëvizje brenda apo jashtë tufës në fjalë dhe vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar me qëllim për therje pa vonesë;
- b) gjedhët në të cilat prania e tuberkulozit është konfirmuar zyrtarisht dhe gjedhët, të cilat mund të kenë qenë infektuar prej tyre të izoloohen brenda fermës;

c) gjedhët të kalojnë një ekzaminim për tuberkuloz pa vonesë;

d) gjedhët në të cilat prania e tuberkulozit është konfirmuar zyrtarisht, gjedhët të cilat janë ekzaminuar, siç përcaktohet në pikën “c”, dhe kanë rezultuar pozitivë dhe gjedhët e konsideruara nga shërbimi veterinar rajonal si të infektuara të izoloohen dhe identifikohen deri në therjen e mëtejshme të tyre sipas nenit 15 të kësaj rregullore;

e) qumështi nga lopët e infektuara mund të përdoret vetëm për ushqimin e kafshëve në të njëjtën fermë pas një trajtimi të përshtatshëm me nxehtësi;

f) përveç dispozitave të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, qumështi nga gjedhet e një tufe të infektuar nuk mund të dërgohet në një stabiliment të përpunimit të qumështit, me përjashtim kur i nënshtrohet një trajtimi të përshtatshëm me nxehtësi;

g) karkasat, gjysmëkarkasat, çerekët e karkasave, pjesë dhe të brendshme nga gjedhët e infektuara të destinuara për përdorim si ushqim për kafshë, të trajtohen në mënyrë të tillë që të shmangët kontaminimi;

h) stabilimentet e tilla si impiantet e shkatërrimit të karkasave të sigurojnë që atje nuk ka rrezik të përhapjes së tuberkulozit nga lëndët e prodhuara në përputhje me rregullat sanitaro-veterinare;

i) plehu nga stallat ose strehime të tjera të përdorura nga kafshët magazinohet në një vend larg fermës së kafshëve, i trajtuar me një disinfektant të përshtatshëm dhe mbahet për të paktën tri javë:

i. përdorimi i disinfektantit nuk kërkohet nëse plehu është i mbuluar me një shtresë plehu të pa infektuar ose me; dhe

ii. mbetjet e lëngshme nga stallat ose strehime të tjera të përdorura për kafshët duhet të disinfektohen nëse ato nuk janë mbledhur në të njëjtën kohë me plehun.

Neni 15

**Eliminimi i kafshëve pozitive me
tuberkuloz**

1. Shërbimi veterinar rajonal siguron që, pas ekzaminimeve patologjike, bakteriale apo me tuberkulinë, kafshët në të cilat prania e tuberkulozit është konfirmuar zyrtarisht dhe ato që konsiderohen nga shërbimi veterinar rajonal të



infektuara, të thehen nën mbikëqyrjen zyrtare sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 30 ditë, nga dita kur pronari ose kujdestari janë njoftuar zyrtarisht për rezultatin pozitiv të testit dhe detyrimin e tij sipas planit të çrrënjësjes për të thehur gjedhët brenda kësaj kohe limit.

2. Në rast se kafshët, të cilat janë ekzaminuar për tuberkuloz dhe kanë rezultuar pozitivë por nuk shfaqin shenja klinike për sëmundjen, shërbimi veterinar rajonal mund të shtyjë jo më shumë se tre muaj periudhën e parashikuar në paragrafin e mësipërm:

a) në rastin e një kafshe femër e cila pret të pjellë viç brenda një periudhe 3-mujore;

b) kur urdhërohet therja e gjithë gjedhëve në një tufë me më shumë se 20 krerë në një rajon në të cilin, për arsye teknike që lidhen me kapacitetin e thertores së caktuar për këtë qëllim, therja nuk mund të kryhet brenda 30 ditëve.

Neni 16

Ripopullimi i ambienteve të kafshëve, kullotave dhe dezinfektimi i mjeteve të transportit

Shërbimi veterinar rajonal siguron që:

1. Pas therjes së gjedhëve sipas neni 15 të kësaj rregullore dhe para ripopullimit, stallat dhe strehime të tjera të tufës, dhe gjithë kontejnerët, pajisjet dhe artikuj të tjerë të përdorur për kafshët, të jenë pastruar dhe dezinfektuar nën mbikëqyrjen zyrtare në përputhje me instruksionet e dhëna nga veterineri zyrtar;

2. Të gjitha mjetet e transportit, kontejnerët dhe pajisjet të janë pastruar e dezinfektuar pas transportit të kafshëve të infektuar, ose materialeve nga të tilla kafshë ose materiale, ose lëndë të cilat kanë qenë në kontakt me kafshë të tilla; ambienti i ngarkimit për të tilla kafshë duhet pastruar e dezinfektuar pas përdorimit;

3. Dezinfektantët që do të përdoren dhe koncentrimi i tyre janë të autorizuar zyrtarisht nga Autoriteti Kompetent.

Neni 17

Kufizimi i lëvizjes së kafshëve të tufës me tuberkuloz

Shërbimi veterinar rajonal, pas therjes së gjedhëve sipas neni 15 të kësaj rregullore, përveç masave të parashikuar në nenin 19, siguron që:

1. Asnjë gjedh nuk mund të largohet nga tufa përkatëse veçse me autorizim të dhënë nga veterineri zyrtar, për therje të menjëhershme.

2. Të kryhen testet për tuberkuloz në tufën në shqyrtim për të konfirmuar që sëmundja është eliminuar.

3. Tufa nuk ripopullohet derisa në gjedhët e moshës mbi 6 javë të mbetura në të, të jenë kryer një ose disa ekzaminime zyrtare për tuberkuloz.

Neni 18

Testet e gjurmimit në tufat e tipit T1 dhe T2

Shërbimi veterinar rajonal siguron që, sipas planit të çrrënjësjes së tuberkulozit, testi *intra dermal* të jetë kryer nën mbikëqyrjen zyrtare në të gjithë gjedhët mbi 6 javë, të paktën çdo 6 muaj në tufat e tipit T1 dhe T2, deri në një kohë kur ato të kalojnë në tufa të tipit T3.

Neni 19

Lëvizja e kafshëve nga tufat e tipit T1, T2 dhe T3

Shërbimi veterinar rajonal siguron, që:

1. Çdo kafshë nga një tufë e tipit T1 dhe e destinuar për në tufë të tipit T2:

a) ka kaluar një test tuberkuline *intra dermal* të kryer brenda 30 ditëve para lëvizjes dhe është e shoqëruar me certifikatë për këtë qëllim nga veterineri zyrtar;

b) është izoluar menjëherë pas arritjes në tufën T2, për të paktën 60 ditë dhe ka kaluar një tjetër test zyrtar tuberkuline *intra dermal* para vendosjes në tufë.

2. Çdo kafshë nga një tufë e tipit T2 dhe e destinuar për në tufë tjetër të tipit T3:

a) ka kaluar një test tuberkuline *intra dermal* të kryer brenda 30 ditëve para lëvizjes dhe është e shoqëruar me certifikatë për këtë qëllim nga veterineri zyrtar;

b) nuk ka qenë në kontakt me kafshë nga tufa me status shëndetësor më të ulët gjatë lëvizjes së saj.

3. Lëvizjet e kafshëve midis tufave të tipit T3, kryhen duke pasur parasysh kërkesat e urdhrimit të ministrit nr. 505, datë 7.12.2016 “Mbi problemet shëndetësore që prekin tregtinë e gjedhit dhe derrave”.



Neni 20

Masat zyrtare të kontrollit në fermat me tuberkuloz

Shërbimi veterinar rajonal siguron që:

1. Masat e kontrollit zyrtar merren për të parandaluar një tufë në të cilën tuberkulozi është eliminuar nga një riinfektim nga burime të tjera infeksioni;

2. Të gjitha lëvizjet e gjedhëve për në dhe midis tufave të mbuluara nga një plan çrënjësje janë objekt i mbikëqyrjes zyrtare;

3. Masat e kontrollit të lëvizjes referuar në pikën 2 mund të aplikohen për në dhe jashtë tufave të lira zyrtarisht nga tuberkulozi.

KAPITULLI IV**MASA SPECIFIKE NË LIDHJE ME LEUKOZËN ENZOTIKE TË GJEDHIT**

Neni 21

Lajmërimi për praninë ose dyshimin e leukozës

1. Prania dhe dyshimi për praninë e leukozës enzotike të gjedhit dhe në veçanti tumoret e sistemit limfatik dhe organeve të tjera të gjedhëve të jenë detyruesisht të lajmërueshme te shërbimi veterinar rajonal nga pronari ose kujdestari i kafshës, teknikët veterinar, çdo mjek veteriner, drejtuesit e njërive të vetëqeverisjes, punonjësit e shërbimit pyjor dhe gjuetarët.

2. Çdo lloj trajtimi terapeutik dhe vaksinimi kundër leukozës enzotike të gjedhit është i ndaluar.

Neni 22

Masat e marra në rast të konfirmimit të sëmundjes së leukozës

Pavarësisht të gjitha masave të marra në rastin e dyshimit të leukozës enzotike të gjedhit, shërbimi veterinar rajonal, kur prania e leukozës është konfirmuar zyrtarisht në një tufë, siguron për parandalimin e përhapjes së sëmundjes dhe në veçanti që:

1. Çdo lëvizje e kafshëve nga tufa të ndalohet. Lëvizja lejohet, vetëm me autorizim nga veterineri zyrtar për qëllim therje menjëherë.

2. Gjedhët e prekur të izoloohen dhe nuk duhet të bien në kontakt me gjedhë që nuk janë të kësaj tufe.

3. Qumështi nga lopët e infektuara mund të përdoret vetëm për ushqim kafshësh, pas trajtimit të duhur me nxehtësi ose shpërndahet për përpunim pas një trajtimi të tillë.

4. Të ushqyerit e kafshëve me qumësht, i cili nuk i është nënshtruar trajtimit me nxehtësi mund të autorizohet për tufa ku të gjitha kafshët do të theren sipas përcaktimeve të nenit 24, pika 1 të kësaj rregullore.

5. Karkasat, gjysmëkarkasat, çerekët e karkasave, pjesë dhe të brendshmet nga kafshët e infektuara që destinohen për përdorim si ushqim për kafshë të trajtohen në mënyrë të tillë që të eliminohet kontaminimi.

6. në stabilimente të tillë si impiantet e shkatërrimit të karkasave, që atje të mos ketë rrezik të përhapjes së leukozës nga materialet e prodhuara gjatë këtij procesi, në përputhje me rregullat sanitaro-veterinare.

7. Fermerët të lajmërojnë veterinerin zyrtar për ngordhjet ose therjet emergjente të çdo gjedhi nga ferma e tyre.

Neni 23

Eliminimi i kafshëve pozitive me leukozë

Shërbimi veterinar rajonal, sipas planit të monitorimit me qëllim çrënjësjes së leukozës, siguron që atje ku:

1. Plani parashikon therjen e të gjithë gjedhëve që i përkasin tufës në të cilën leukoza është konfirmuar zyrtarisht, këto gjedhë të theren brenda një periudhe, të caktuar nga shërbimi veterinar rajonal;

2. Plani parashikon për therje vetëm ato gjedhë në të cilat leukoza është konfirmuar zyrtarisht dhe therja të bëhet brenda një periudhe prej 30 ditësh pas njoftimit zyrtar të pronarit ose kujdestarit, për rezultatin e ekzaminimeve.

Neni 24

Kufizimi i lëvizjes së kafshëve të tufës me leukozë

Shërbimi veterinar rajonal, në rastin e therjes sipas nenit 23, pika 2, të kësaj rregullore, siguron që:

1. Asnjë gjedh të mos largohet nga tufa përkatëse, përveçse me autorizim nga veterineri zyrtar për qëllim therje menjëherë;



2. Testet për leukozën janë kryer në tufën përkatëse për të konfirmuar që sëmundja është eliminuar;

3. Përdoren për të ripopulluar tufën vetëm gjedhë nga tufat e konsideruara nga shërbimi veterinar rajonal të pa infektuara nga leukoza.

Neni 25

Ripopullimi, dezinfektimi i ambienteve të kafshëve dhe i mjeteve të transportit

Shërbimi veterinar rajonal siguron që:

1. Pas therjes së kafshëve sipas nenit 23 të kësaj rregullore dhe para ripopullimit, stallat dhe të tjera strehime të tufës, të gjithë kontejnerët, pajisjet dhe artikuj të tjerë të përdorur për kafshët, të jenë pastruar dhe dezinfektuar nën mbikëqyrjen zyrtare në përputhje me instruksionet e dhëna nga veterineri zyrtar;

2. Të gjitha mjetet e transportit, kontejnerët dhe pajisjet të jenë pastruar e dezinfektuar pas transportit të kafshëve nga tufa e infektuar, apo materialeve nga të tilla kafshë, ose materiale ose lëndë të cilat kanë qenë në kontakt me kafshë të tilla. Ambientet e ngarkimit për të tilla kafshë të jenë pastruar e dezinfektuar pas përdorimit;

3. Diezinfektantët që do të përdoren dhe koncentrimi i tyre janë të autorizuar zyrtarisht nga Autoriteti Kompetent.

Neni 26

Kufizimi i lëvizjes së kafshëve

Shërbimi veterinar rajonal siguron që gjedhët nga një tufë e klasifikuar si jo e dyshuar, mos të bien në kontakt me gjedhë nga tufa të klasifikuara si të dyshuara.

KREU V

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Neni 27

Raporti përfundimtar

Shërbimi veterinar rajonal i dërgon Autoritetit Kompetent një raport mbi zbatimin e programeve të kontrollit të sëmundjeve të parashikuara në këtë rregullore brenda 3 javësh pas përfundimit.

KËRKESË

Nr. 8946, datë 16.10.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës që lidh rrugët ‘Pjetër Budi’, ‘Qamil Guranjaku’ dhe ‘Stavri Vrinjao’”, Tiranë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, si dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Tiranë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 170 228 501.1 (njëqind e shtatëdhjetë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e një pikë një) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR

I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Artan Shkreli



LISTA PARAPRAKTE PËR PASURITË, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS QË LIDH RRUGËT "PJETËR BUDI", "QAMIL GURANJAKU" DHE "STAVRI VRINJAO", TIRANË.

Nr.	EMËR MBIEMËR	Z. K.	Lloji pasurisë	Nr. Pas.	SIP. Përgj. Truall m ²	SIP. Përgj. Truall m ²	Cinimi për Truall lekë/m ²	Objekti sip. Përgj. m ²	Objekti sipërfajia që preket në m ²	Cinimi për Objekt lekë/m ²	VLERA (truall + prekur) lekë	VLERA (objekti i prekur) lekë	VLERA (truall + objekti) lekë	SHËNIME	KONFIRMIM ZVRPP, TIRANË
1	Shet	8160	Truall	4/221	1519	20.9	66969				0	0	0	Drejtoria e Higjenes	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
2	Adem Muharrem Joca, Mahmude Muharrem Joca	8160	Truall	4/349	618	528	66969				35359632.00	35359632.00	35359632.00	VKKKP, mbi kete truall ka ndërtim pa leje. Bazuar ne leje leg. Eshte regjistruar ndertesa me nr. pas. 4/953/ND.	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
3	Adem Muharrem Joca, Mahmude Muharrem Joca	8160	Truall	4/350	365	360	66969				24108840.00	24108840.00	24108840.00	VKKKP, D. TRASH.	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
4	Adem Muharrem Joca, Mahmude Muharrem Joca	8160	Truall	4/351	56	56	66969				3750264.00	3750264.00	3750264.00	VKKKP	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
5	Drita H. Male, Gazim H. Male, Mimoza H. Male, Neriman Xh. Male, Ilirjan A. Male, Alim A. Male, Enkelelda A. Male	8160	Truall	4/357	148	57	66969				3817233.00	3817233.00	3817233.00		Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
6	Ymer Halit Jonuzi	8160	Truall	4/739	69	29.7	66969				1988979.30	1988979.30	1988979.30	VKKP	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
7	Shet	8160	Truall	4/750	257.70	47.2	66969				0	0	0	URDH, PL. RIL, URDHER KORR.	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
8	Arian Spro Syzru	8160	Truall	4/749	101	12.5	66969	77.47	0.00		837112.50	0	837112.50	leje legalizimi, U. KORR, dt. 05.11.2012, tek shkr. 41481/1 rivlerisim per 80 m2 te perfunduar me kontrate shetje.	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
9	Shet	8160	Truall	4/920	807.45	592.9	66969				0	0	0	ND. PAS	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
10	14 Bashkepronarë Myzyri, Jashari, Cela	8160	truall	4/834	96	43	66969				2879667.00		2879667.00	V. K. K. P. URDHER	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
11	Shet	8160	Truall	4/740	30.00	25.3	66969				0	0	0	PL. RIL.	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
12	Fejzi Isa Domini	8160	truall	4/216	261	239	66969				16025681.70		16025681.70	VKKM, dt. 29.07.2015	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
13	Ymer Halit Jonuzi	8160	Truall	4/743	81	81	66969				5424489.00		5424489.00	PL. RIL.	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019



14	Shtet	8160	Truall	4742	182.50	104.3	66969						0	0	PL. 2240	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
15	Shtet	8160	Truall	4856	58.06	52.5	66969						0	0	ND. PAS	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
16	Myllazim Islam Deharaj	8160	Truall	4404	250.00	239.5	66969	0.00	0.00	16039076	0.00	16039076	0.00	16039076	ND. PAS.; ka ndertim pa leje, shpronosuar mbi vkm nr. 616; dt. 07.07.2015	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
17	Edrin Koço Katundi	8160	Truall	4403	30	30	66969			2009070.00		2009070.00		2009070.00	K.SH.; Mbi kete truall ka ndertim pa leje.	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
18	Gëzim Hali Peshkopia Anila Ruzhdi Peshkopia	8160		4332	100	13.9	66969	65.00	0.00	930869.10	0	930869.10	0	930869.10	K.SH. DT. 11.04.2017, Njere M. Demollari; pasuria bllokohet ne favor te BANKES SOCIETE GENERALE ALBANIA per shumën 360000 lek. Objekti 2 katësh, kati perdhje sip. 65 m2 dhe kati pare 70.2 m2	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
19	Aishe - Gori, Jemin Kasem Skenderi, Met – Murat Ndreke Ndoe Pietrushi, Namik Hoxha	8160	Truall	4451	73	73	66969			4888737.00		4888737.00		4888737.00	ND. PAS	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
20	Sotraq Vasil Naçi	8160	Truall	4452	17	17	66969			1138473.00		1138473.00		1138473.00	Ka nje ndertim pa leje-K. SHITJE, KUFIZIM te sjellit origjinalin e kontrates se shijes	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
21	Sotraq Vasil Naçi	8160	Truall	4712	22	22	66969			1473318.00		1473318.00		1473318.00	K. SHITJE. Mbi kete truall ka nje ndertim pa leje	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
22	Bashkëpunimet Lohja, Muça, Çoku, Hasmuça	8160	Truall	4766	378	378	66969			25314282.00		25314282.00		25314282.00	D.T. me vendim Gjykate, nr 340 dt. 25.01.2007, mbi kete truall eshte regj. Ndertesat nr. 4932 ND. (Garazh)	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
23	Myzafer Xhevit Allaj	8160	Truall	4335	22	22	66969			1473318.00		1473318.00		1473318.00	HIP. 28/1999, ne truall ka nje objekt pa leje	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
24	Zaqe Karafil Islamaj	8160	Truall	4767	22	22	66969			1473318.00		1473318.00		1473318.00	145/2001 dt. 12.01.2009,	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
25	Shtet	8160	Truall	4709	37.30	33.0	66969			0	0	0	0	0	ne kete truall ka ndertim pa leje	Konfirm. ZVRPP ne shkresen shkresen nr. prot. 1340/1, date 30.01.2018.
26	Shtet	8160	Truall	4708	98.00	98.0	66969			0	0	0	0	0		Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019
27	Krisanthi Gogo Jani	8160	Truall	4377	88	46	66969			3080574.00		3080574.00		3080574.00	K. Dhurimi, Dt. 02.05.2007, mbi kete truall ndodhet ndertesat 4/377-ND(shtese anore), vol 47 fq 249,	Konfirm. ZVRPP ne shkresen nr. prot. 41481/1 date 31.01.2019



28	Krisanthi Gogo Jani	8160	Truall	4381	50	50	66969						3348450.00	3348450.00	ND. PAS	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
29	Elvana Stefan Spahio (Prifti)	8160	Truall	4786	222	222	66969						14867118.00	14867118.00	BASHKIM PASURIE, DT. 01.03.2010, u vendos barra hipotekore mbi pasurine nga drejtoria Tatinore, me shkresën nr. 36820 dt. 12.06.2014	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 41481/1 datë 31.01.2019
Vlera paraprahe																170,228,501.10

SHËNIME:

1. Për truallin çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, dt.03.03.2016.
2. Pasuritë e prekura nga projektet, Konfirmohen nga ZVRPP, Tiranë, me shkresat nr. prot. 13401/1, datë 30.01.2018, me nr. prot. 13403, datë 27.02.2018, me nr. prot. 12248/1, datë 30.05.2018, dhe me nr. prot. 41481/1, datë 31.01.2019.
3. Pasuritë me nr. 4404, dhe me nr. 4301, sipas kërkesës së M.L.E. nr. Prot. 20123, datë 22.05.2019, si edhe bazuar në verifikimin nga Geoporalat (ortofoto e vitit 2015) kemi hequr sip. e ndërtesës 50.05 m² nga pasuria nr. 4404 dhe 4301 nga tabella e llogaritve paraprahe sepse ato nuk gjenden në terren në kohen kur është realizuar projekti.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë